Shoqata Bamirëse Ehlu Bejti dhe As'habët

# Dashuria Dhe Afërsia Mes Familjes Fisnike Dhe Sahabëve

Qartësime kuptimplota për lidhjen e ngrohtë mes Familjes Fisnike dhe Sahabëve




Pregaditi
Ali ibn Hamdiet-Temimi
Nënkryetari i Qendres për Hulumtime dhe Studime në këtë Shoqatë

Sh.B NUN

Albanian

Shtëpia Fisnike dhe sahabët

# DASHURI DHE AFËRSI

Qartësime kuptimplota për lidhjen e ngrohtë
mes Familjes Fisnike dhe sahabëve

Përgatiti: Alij ibën Hamed et-Temimi

Përktheu: Omer R. Berisha

Kryeradaktor: Rafet Zaimi

Redaktor gjuhësor: Arian Koçi

Redaktor teknik: Suhejb Xhemaili

Botues: Bekir Halimi

Katalogizimi i librit gjindet në bibliotekën kombëtare në Shkup.
© NuN-2017

Shtëpia botuese “NuN”
rr.Petre Georgiev nr.6 . përball ambullantës Bit Pazaz
1000 Shkup/Maqedoni
tel&fax: +389 2 323 0827
www.nun.com.mk

PËRGATITI: ALIJ IBËN HAMED ET-TEMIMI

Shtëpia Fisnike dhe sahabët

# DASHURI DHE AFËRSI

## Qartësime kuptimplota për lidhjen e ngrohtë mes Familjes Fisnike dhe sahabëve

NUN

Shkup, 2018

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

# HYRJE

Lavdia dhe falënderimi i takojnë Allahut, që e dërgoi të Dërguarin e Tij me fenë e vërtetë për t'u shfaqur mbi çdo fe tjetër. Allahu mjafton për Dëshmitar. Lavdërimi, paqja dhe shpëtimi i madh nga Zoti qofshin mbi Profetin e njerëzimit, që erdhi për ta si përgëzues dhe paralajmërues, po ashtu edhe mbi familjen e tij fisnike dhe mbi shokët e tij të pastër dhe të mirë, të cilët kumtuan rrugën e Profetit.

Këto janë njëzet e katër qartësime që brohorasin me zërin më të lartë: Familja Profetike dhe sahabët janë të dashur dhe të afërt. Këtu kemi argumentet e qarta dhe aludimet e drejtpërdrejta se Familja Fisnike dhe shokët e Profetit, alejhi salatu ue selam, ishin tamam siç ka thënë Allahu i Lartësuar për ta: ***"të mëshirshëm mes vete"***. Ata ishin gjenerata më e mirë përreth Pejgamberit më të mirë. Ata u edukuan dhe u arsimuan te Pejgamberi i tyre, alejhi salatu ue selam, që të gdhihen mësues të njerëzimit me karizmën dhe moralin e tyre përpara fjalëve të tyre.

Këtu do paraqesim mbi pesëdhjetë krushqi që vazhduan përgjatë pesë apo gjashtë gjeneratash të bijve dhe nipave, të cilat janë dëshmi për lidhjen e fortë shoqërore, për dashurinë dhe për mëshirën që kishin mes vete.

Duke pasur parasysh rëndësinë e fakteve në përçimin e informacionit dhe ngulitjes të tij në mendje, duke qenë në version të shkurtuar dhe të vërtetuar, organizata jonë mbështeti këtë metodë për sqarimin e afërsisë së madhe mes Familjes Fisnike dhe sahabëve të nderuar.

Ju paraqesim disa pika me rëndësi për sa u përket këtyre krushqive:

1. Këto krushqi dhe emra janë regjistruar në referencat e të dyja palëve, te sunitët dhe shiat.

2. Librat e historisë dhe bibliografitë kur përmendin martesat, i përmendin kalimthi dhe jo deri në përpikëri, prandaj me siguri ka pasur edhe krushqi që nuk i kanë regjistruar dhe nuk na janë transmetuar fare.

3. Kultura arabe gjithmonë e ka madhëruar çështjen e martesës dhe krushqisë. Arabët nuk martonin e as nuk martoheshin përveçse me ata që kishin soj dhe histori fisnike. Pastaj erdhi Islami dhe këtë koncept e përforcoi edhe më shumë, përveç asaj se devotshmërinë e radhiti si kriter të parë. Kështu që përzgjedhja e shtratit është kuptim burimor islam, e cila vazhdon edhe në ditët e sotme.

4. Përzgjedhja e emrave është prirje shoqërore botërore dhe nuk përkufizohet vetëm te muslimanët. Popujt e tokës i emërtojnë fëmijët e tyre vetëm me emrat e njerëzve të dalluar dhe të afërt ose me emrat e realitetit shoqëror ku jetojnë.

5. Fisi Beni Hashimi nuk i jepnin nuse përveçse atij që e meritonte për nga feja dhe prejardhja, madje ndodhte që edhe pushtetarët të ndërhynin në prishjen e kurorës nëse ndonjë hashimije martohej me dikë që nuk i plotësonte ato kritere. Për këtë ka dëshmi të shumta historike.

Allahun e lusim të na bëjë dobi me këtë botim dhe t'i afrojë zemrat e muslimanëve me të vërtetën.

Alij ibën Hamed et-Temimi
27 maj 2008


محمد
صلى الله عليه وسلم

# KRUSHQITË MES PEJGAMBERIT, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFSHIN MBI TË DHE KALIFËVE TË MENÇUR, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TYRE




PREJARDHJE DIREKTE
MARTESË
VAJZAT E PEJGAMBERIT
GRATË E PEJGAMBERIT

I DËRGUARI, ALEJHI SALATU UE SELAM, KA THËNË:
"PËRMBAJUNI RRUGËS SIME DHE RRUGËS SË KALIFËVE TË MENÇUR DHE TË UDHËZUAR."
(HADITH SAHIH – I SHËNUAR NË KATËR SUNENET DHE MUSNEDIN E AHMEDIT.)

QARTËSIMI I PARË

## KRUSHQITË MES PEJGAMBERIT, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFSHIN MBI TË, DHE KALIFËVE TË MENÇUR

Ky fakt paraqet lidhjen shoqërore të katër kalifëve të mençur me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam. Ebu Bekër es-Siddiku, radijAllahu anhu, ishte burri i parë që pranoi Islamin dhe që e martoi bijën e tij Aishen me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, e cila konsiderohet gruaja e tretë e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, beqarja e vetme në mesin e tyre dhe më e reja për nga mosha, mirëpo ajo ishte përcjellësja më e madhe e haditheve të ndershme dhe sahabët i referoheshin asaj për fetva.

Nëna jonë, Aishja, radijAllahu anha, e cila ndërroi jetë në vitin 57h., jetoi si bashkëshorte e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, nëntë vite, pra derisa ai ndërroi jetë.

Aishja mbeti grua e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, deri në fund të jetës së tij. Ai ndërroi jetë në dhomën e saj, në ditën kur i përkiste asaj dhe u varros në dhomën e saj. Këtu kemi një aludim të qartë për atë se sa ishte e afërt me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, dhe për atë se sa ishte i kënaqur ai prej saj.

Me këtë, Ebu Bekri qe vjehërr i Profetit fisnik, madje shoqërimi i tij me Profetin, alejhi salatu ue selam, vazhdoi edhe pas vdekjes duke u varrosur përkrah tij. Allahu nuk do lejonte që në afërsi të krijesës më të mirë, salallahu alejhi ue selam, të varrosej askush përveç atij që është nga besimtarët e zgjedhur.

Kurse nga Omer el-Faruku, i Dërguari mori për grua vajzën e tij Hafsanë, radijAllahu anha, atë grua agjëruese dhe të devotshme në vitin e tretë të hixhretit, e cila mbeti grua e tij derisa ai ndërroi jetë. Pra, Hafsa mbetet ndër bashkëshortet e tij dhe mbetet besnikja e umetit për mus'hafin sepse mus'hafin që kish tubuar Ebu Bekri dhe sahabët e tjerë ia kishin lënë Hafsasë, radijAllahu anha, që ta ruante.

Omer el-Faruku kishte vazhduar t'i rrinte afër Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, që nga dita kur pranoi Islamin e deri në ditët e sotme, madje deri në ringjallje, sepse edhe ai është i varrosur përkrah Muhamed Mustafasë në dhomën e ndershme të Aishes.

Kjo konsiderohet dëshmi e qartë dhe e ndritshme për thellësinë e lidhjes që kishin.

Kurse për lidhjen shoqërore të Osmanit dhe Aliut, radijAllahu anhuma, me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, do të flasim në faktet vijuese.

# BIJAT E NJERIUT MË TË MIRË, MUHAMEDIT ﷺ

## ZEJNEBJA رضي الله عنها

-BIJA MË E MADHE E PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM
-U LIND DHJETË VJET PARA SHPALLJES
-U MARTUA PARA ISLAMIT ME DJALIN E TEZES SË SAJ, EBUL AS IBËN REBI
-NDËRROI JETË NË VITIN 8H, DUKE QENË GJALLË PEJGAMBERI, ALEJHI SALATU UE SELAM, SI PASOJË E RRËZIMIT NGA DEVEJA QË IA BËNË IDHUJTARËT KUR AJO BËRI HIXHRET
-ISHTE NËNA E ALIUT (VDIQ SA ISHTE I VOGËL) DHE E UMAMES, E CILA U MARTUA ME ALIUN, RADIJALLAHU ANHU, PASI VDIQ FATIMJA, RADIJALLAHU ANHA.

NËNA E TË GJITHAVE ISHTE ZONJA E GRAVE TË TË GITHË BOTËS DHE NËNA E BESIMTARËVE HATIXHE BINT HUVEJLID رضي الله عنها

## UMMU KULTHUM رضي الله عنها

-BIJA E TRETË E PEJGAMBERIT
-LINDI PAK PARA SHPALLJES, PAS RUKAJJES
-U MARTUA ME OSMANIN PASI VDIQ MOTRA E SAJ RUKAJJA, PRANDAJ DHE OSMANI MORI NOFKËN DHU NURAJN – PRONARI I DY DRITAVE
-NDËRROI JETË NË SHABAN TË VITIT 9H, DUKE QENË GJALLË PEJGAMBERI
-NUK PATI FËMIJË.

“O PROFET, THUAJU GRAVE TË TUA, EDHE **VAJZAVE TË TUA,** EDHE GRAVE TË BESIMTARËVE, LE T'I LËSHOJNË MBULESAT E VETA.”
(Ahzab: 59)

## FATIME رضي الله عنها

-ZONJA E GRAVE TË GJITHË BOTËS
-BIJA MË E VOGËL E PROFETIT, ALEJHI SALATU UE SELAM
-U LIND NJË VIT PARA SHPALLJES
-U MARTUA ME ALIUN NË VITIN 2H.
-NDËRROI JETË NË RAMAZAN TË VITIT 11H.
-ISHTE NËNA E HASANIT DHE HUSEJNIT, DY ZOTËRINJTË E DJELMOSHAVE TË XHENETIT, SI DHE NËNA E ZEJNEBES DHE UMMU KULTHUMES.

TË GJITHA ISHIN BESIMTARE DHE KRYEN SHPËRNGULJEN NGA MEKA NË MEDINË

## RUKAJJA رضي الله عنها

-U LIND SHTATË VITE PARA SHPALLJES
-U SHPËRNGUL ME BASHKËSHORTIN E SAJ OSMANIN NË ETIOPI
-NDËRROI JETË NË MEDINË NDËRSA MUSLIMANËT ISHIN NË BETEJËN E BEDRIT KURSE AJO ISHTE E SËMURË ME FRUTH
-ISHTE NËNA E ABDULLAH IBËN OSMANIT, I CILI VDIQ NË VITIN 6H.

**REFERENCA MË TË RËNDËSISHME:** 1. IBËN HISHAM – SIRA NEBEUIJE, 2/9; 2. DHEHEBI – TARIHUL ISLAM, 1/13; 3. IBËN ASAKIR – TARIHU DIMESHK, 3/125; 4. IBËN KETHIR – EL-BIDAJE UEN NIHAJE, 2/294; 5. IBËN HAXHER – EL-ISABEH, BIOGRAFIA NR.11181; 6. IBËN ABDUL BER – EL-ISTIIAB, 1/17; 7. IBNUL ETHIR – USDUL GABEH, 1/10; 8. ES-SADUK – EL-HISAL, FQ.404; 9. ET-TUSI – TEHDHIBUL AHKAM, 3/333; 10. MAZENDERANI – SHERH USULIL KAFI, 7/144; 11. TUBRUSI – TAXHUL MEVALID, FQ.9; 12. IBËN HASHAB – TAXHU MEVALIDIL EIMMEH, FQ. 7; 13. IBËN SHEHRASHUB – MENAKIBU ALI EBI TALIB, 3/90; 14. EL-MUFID – EL MESAILU SIREVIJE, FQ.94; 15. NEMAZI ESH-SHAHRUDI – MUSTEDRAKAT ILMI RIXHAL, BIOGRAFITË NR. 9227, 15860, 9590 DHE 18068; 16. EL-MUFID – EL MUKNIAH, FQ. 332; 17. ET-TUSI – EL MEBSUT, 4/159; 18. ET-TUSI – MISBAHUL MUXHTEHID, FQ. 80 DHE 622; 19. EL-HILJI – TEDHKIRATUL FUKAHA, 2/604; 20. EL-HUMEJRI EL-KAMI – KURBUL ISNAD, FQ. 9; 21. EL-HAV'I – MU'XHEMU RIXHALIL HADITH, 12/139, 24/208, 19/305 DHE BIOGRAFIA NR. 15626; 22. EL-MEXHLISI – BIHARUL ENUAR, 42/95; 23. ELHUR ELAMILI – UESAIU SHIAH, 3/139; 24. ET-TUSI – EL-ISTIBSAR, FQ. 485; 25. EL-BAHRANI – EL HADAIKU NADIRAH, 4/85; 26. EL-HILJI – MUNTEHA TALEB, 1/446; 27. ET-TUSTURI – KAMUSU RIXHAL, BIOGRAFITË NR. 119, 343, 8 DHE 136.

QARTËSIMI I DYTË

## BIJAT E NJERIUT MË TË MIRË, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFSHIN ME TË

Ky fakt, bijat e njeriut më të mirë, ka të bëjë me biografitë e bijave të Profetit më fisnik dhe të Pejgamberit më të madh, Muhamedit alejhi salatu ue selam. Të gjitha ato qenë besimtare dhe kishin bërë hixhret. Nëna e tyre ishte zonja e grave të të gjithë botës, Hatixheja bija e Huvejlidit, Allahu qoftë i kënaqur prej saj.

Më e madhja ishte Zejnebja, radijAllahu anha, e cila lindi dhjetë vjet para shpalljes. Ajo qe martuar me djalin e tezes së saj, Ebul As ibën Rebiun të fisit Abdumenaf (kushërinj të Pejgamberit, alejhi salatu ue selam), nga i cili lindi një djalë Ali, por që ndërroi jetë i vogël, dhe një vajzë Umame, e cila u martua me Ali ibën Ebi Talibin, radijAllahu anhu, pasi ndërroi jetë tezja e saj, Fatimja, radijAllahu anha.

Pastaj zonja e grave të të gjithë botës dhe nëna e dy luleve, Hasanit dhe Husejnit, kam për qëllim "Zehranë" pra, Fatimen, radijAllahu anha, e cila u lind një vit para shpalljes. Ajo ishte bija më e vogël dhe më e mira e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, që u martua në vitin 2h. me kalifin e mençur dhe imamin e drejtë, Ali ibën ebi Talibin. Ajo ndërroi jetë në vitin 11h, vetëm gjashtë muaj pasi ndërroi jetë i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin me të.

Pastaj Rukajja, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, e cila kishte bërë dy shpërngulje. Ajo ishte lindur shtatë vite para shpalljes dhe ishte martuar me Osman ibën Affanin, radijAllahu anhu, pasi u shkurorëzua nga djali i Ebu Lehebit. Në fillim, u shpërngul me burrin e saj Osmanin drejt Etiopisë dhe lindi prej tij Abdullahun, por që vdiq i vogël, e pastaj u shpërngulën përsëri së bashku, por kësaj radhe drejt Medinës. Ajo ndërroi jetë gjatë Betejës së Bedrit në vitin 2H.

Pastaj Ummu Kulthumja, radijAllahu anha, e cila lindi para shpalljes, pas Rukajjes. Ajo ishte shpërngulur në Medinë dhe pas vdekjes së motrës (Rukajjes) ishte martuar me Osman ibën Affanin, Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Ajo nuk lindi fëmijë dhe ndërroi jetë në vitin 9h.

Të gjitha ndërruan jetë duke qenë gjallë Pejgamberi, alejhi salatu ue selam, përveç Zehrasë, e cila ndërroi jetë gjashtë muaj pas tij. Të gjithë librat e historisë pajtohen se ato ishin bijat e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, dhe ato janë për qëllim në Kur'anin Fisnik kur Allahu tha: "**EDHE VAJZAVE TË TUA"** pra, një numër vajzash dhe jo vetëm një. Të njëjtën ka aluduar edhe Suneti i pastër dhe ixhmai i dijetarëve të hershëm.

Lexues i shtrenjtë! Këtu të kemi sjellë edhe 27 referenca të ndryshme ku theksohen këto dhe me këtë mësojmë se ajo që trumbetojnë disa njerëz se Fatimja, radijAllahu anha, është bija e vetme, kurse të tjerat ishin vetëm thjeshtra të ardhura nuk ka asnjë bazë vërtetësie.

# MARTESA E BEKUAR E
# ALIUT ME FATIMEN رضي الله عنها

## DASMA:

SADI رضي الله عنه PËRGATITI NJË DASH DHE DISA ENSARË TË TJERË SOLLËN DISA OKË ME KALLAMBOQ.



## BANESA:

ATË IA DHUROI SAHABIU HARITHEH IBËN NUMAN EL-ENSARI.



## MOBILIET:

ATO IA BLENË EBU BEKËR SIDDIKU, BILALI DHE SELMAN FARISIU رضي الله عنهم PASI SUGJEROI PEJGAMBERI ﷺ. ATO ISHIN NJË TAPET ME PËLHURË THESI, DISA COPA ÇARÇAFI, NJË IBRIK PËR UJË, NJË QYP, NJË MBULESË DHE NJË HAVAN.



## KOHA DHE VENDI:

VITI 2H., PAS KTHIMIT NGA BETEJA E BEDRIT NË MEDINËN PROFETIKE.



## SHKUESIA:

ISHIN EBU BEKR SIDDIKU, OMER IBËN HATTABI DHE SAD IBËN MUADHI رضي الله عنهم QË PROPOZUAN MARTESËN E FATIMES رضي الله عنها ME ALIUN رضي الله عنه



## PRIKA (MEHRI):

PARZMORJA PERSONALE E ALIUT, TË CILËN IA SHITI OSMANIT PËR KATËRQIND DËRHEMË. KUR ALIU رضي الله عنه I MORI NË DORË ATO TË HOLLA, OSMANI IA KTHEU ATIJ PARZMOREN DHE I THA: "KJO DO TË JETË DHURATA IME PËR TY". KËSHTU QË ALIU رضي الله عنه MORI SI DËRHEMËT ASHTU EDHE PARZMOREN.






(٢) فضائل الصحابة للإمام أحمد بن حنبل حديث (١١٧٨)




(١) كشف الغمة للأربلي ١/٣٤٢






## QARTËSIMI I TRETË:

# MARTESA E BEKUAR E ALI IBËN EBI TALIBIT DHE FATIME EZ-ZEHRAS, RADIJALLAHU ANHUMA

Te ky fakt mund të vëresh nga referenca të ndryshme se sahabët, radijAllahu anhum, kishin rol të madh në martesën e Aliut, radijAllahu anhu, me Fatimen, radijAllahu anha. Çka i shtyu ta bënin këtë përveçse dashuria dhe afërsia? Argumentet na thonë:

1. Ata që e nxitën Aliun, radijAllahu anhu, të martohet me Fatimen, radijAllahu anha, ishin Ebu Bekri, Omeri dhe Sad ibën Muadhi, radijAllahu anhum, menjëherë pasi u kthyen nga Beteja e Bedrit në vitin 2h.

2. Ai që pagoi prikën e Aliut, radijAllahu anhu, ishte Osman ibën Affani, radijAllahu anhu. Kjo u realizua duke blerë nga Aliu parzmoren për katërqind dërhemë, e kur Aliu mori paratë, Osmani i tha: “Parzmorja është dhuratë prej meje për ty”. Në këtë mënyrë i ruajti nderin dhe krenarinë Aliut, radijAllahu anhu, pa iu lëvduar dhe pa treguar epërsi financiare mbi të. Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve.

3. Duke qenë se ensarët u gëzuan nga kjo lidhje, u çua Sadi dhe përgatiti një dash për këtë dasmë, ndërsa disa ensarë morën pjesë duke sjellë ca okë me kallamboq. Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre.

4. Ende s’ka përfunduar roli i ensarëve. Haritheh ibën Numan el-ensari, radijAllahu anhu, shtëpinë që e kishte në fqinjësi të Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, ia dhuroi Aliut dhe Fatimes, radijAllahu anhuma.

5. Tjetra, por jo e fundit, u ngritën disa sahabë me në krye Ebu Bekrin për të blerë edhe mobiliet e duhura për çiftin e ri.

Çfarë ndihme tjetër që kanë nevojë të porsamartuarit nuk ua ofruan sahabët?!

Si mendon, çfarë i shtyu ta bënin atë? Çfarë shpresuan pas gjithë asaj?

Pasha Allahun, s’kishte asgjë tjetër përveç dashurisë së sinqertë dhe besnikërisë ndaj Profetit dhe familjes së tij.

# DISA EMRA QË I DONTE ALIU DHE DJEMTË E TIJ RADIJALLAHU ANHUM

**DASHURIA DHE BESNIKËRIA**

*Këta ishin shtytësit e vetëm për Aliun, djemtë e tij dhe për pasardhësit e tyre, radijAllahu anhum, që t'i emërtojnë djemtë dhe vajzat e tyre me këta emra. S'do mend që njeriu nuk do t'i emërtonte loçkat e shpirtit me emrat e atyre që i urren apo i armiqëson, përkundrazi, do të zgjedhë emrat më të mirë, më fisnikë, më të përshtatshëm dhe më të dashur për zemrën*





REFERENCAT MË TË RËNDËSISHME

1. Ibën Asakir – Tarih Dimeshk
2. Ibën Sad – Et-Tabekatul Kubra
3. Ibën Hazëm – Xhemheratu Ensabil Arab
4. Zubejr ibën Bekkar – Nesebu Kurejsh;
5. Ibën Anbe – Umdetu Talib
6. Beladhiri – Ensabul Eshraf
7. El-Jakubi – Tarih
8. Ebul Ferexh el-Esfehani – Mukatilu Talibin
9. Abas el-Kami – Muntehal Amal
10. Ibën Habib – El-Muhbir
11. Ibën Taktaki – El-Esili
12. El-Erbili – Keshful Gumme
13. El-Mufid – El-Irshad
14. El-Hav'i – Mushemu Rixhalil Hadith
15. Alij Nemazi esh-Shehrudi – Mustedrekatu Ilmi Rixhal


Vërejtje me rëndësi: Ky trung përfshin disa emra dhe prejardhje e jo të gjithë. Nuk janë përmendur shumë prej bijve dhe pasardhësve të Aliut, radijAllahu anhu, si Fatime, Xhafer, Zejneb për shkak të hapësirës së ngushtë që na mundësohet këtu.

QARTËSIMI I KATËRT

## DISA EMRA QË I DONTE ALIU DHE DJEMTË E TIJ, RADIJALLAHU ANHUM

Thellohu pak në këtë trung familjar të bekuar!

Emra si Ebu Bekër, Omer dhe Osman janë të pranishëm në Kerbela dhe bien shehidë!

Eja të ndalemi pak te kjo çështje.

Ebu Bekër, bir i i Ali ibën Ebi Talibit si dhe Ebu Bekër bir i Hasan ibën Ali ibën Ebi Talibit; Omer ibën Hasen, pastaj Omer ibën Husejn së bashkë me xhaxhallarët Abas dhe Osman, djemtë e Ali ibën Ebi Talibit, radijAllahu anhu. Nëna e këtyre dy të fundit qe Ummul Benin el-Kulabije.

Të mos harrojmë edhe Omerin, birin e Ali ibën Ebi Talibit, i cili jetoi më së shumti, as Omerin dhe Osmanin, djemtë e Ali ibën Husejnit!

Kjo dukuri vazhdoi në brezin e gjashtë, kur Musa el-Kadhimi i emërtoi dy djem të tij me emrat Ebu Bekër dhe Omer.

A dëshiron edhe më nga Familja e Shtëpisë Profetike, të cilët patën një dashuri dhe vëllazëri aq të kulluar? Të cilët ia njohën muhaxherëve dhe ensarëve vlerën, mirësinë dhe shoqërinë që ia bënë gjyshit të tyre, Muhamedit, alejhi salatu ue selam?!

Ja edhe më!

Aishe, bija e Xhafer es-Sadikut!

Aishe, bija e Musa el-Kadhimit!

Aishe, bija e Ali Ridasë!

Lexues i nderuar... ka edhe më shumë nga këto lidhje unike dhe emërtime që të kënaqin në brenditë e librave bazë.

Pas gjithë kësaj, a mendon se ende do t'i besojmë fjalët e disa mashtruesve orientalistë dhe të disave që u përlyen me idetë e tyre, se kinse lidhja mes këtyre të dashurve ka qenë plot armiqësi dhe urrejtje?!

Jo, pasha Allahun!

Kërkojmë strehim tek Allahu nga vesveset dhe mashtrimet që duan t'ua bëjnë muslimanëve!

Tabela 5: KRUSHQITË[1] MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, DHE FAMILJES SË EBU BEKRIT, RADIJALLAHU ANHUM

Allahu ka thënë: **"Muhamedi është i Dërguar i Allahut, ndërsa ata që besuan së bashku me të janë të ashpër ndaj mohuesve dhe të mëshirshëm mes vete."**

Po ashtu ka thënë: **"Thuaj: "Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve."**

Këtë trung krushqie e theksuan dhe e dëshmuan burimet e muslimanëve, se Familja Fisnike dhe sahabët janë një, i emërtojnë bijtë e tyre me emrat e njëjtë, krushqitë mes tyre vazhdojnë si para ashtu edhe pas ngjarjeve të grindjes që regjistroi historia. Krejt kjo thekson vazhdimësinë e raportit të ngrohtë mes Familjes Fisnike dhe sahabëve, tabiinëve dhe atyre që pasuan. Prandaj, le të kemi kujdes nga të paqenat në histori![2]

1 Këto krushqi i kanë vërtetuar dijetarët: El-Mufid në librin e tij *El-Irshad,* fq.270; Muhamed el-A'lemi el-Hairi në librin *Teraxhumu E'lami Nisa*, fq.278; Ibnu Anbe në librin *Umdetu Talib,* fq.225; Ibën Taktaki në librin *El-Esili,* fq.149; Musab ez-Zubejri në librin *Nesebu Kurajsh*.

2 Ngjarje të rëndësishme në historinë islame: 1. Vdekja e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, në vitin 11h; 2. Zgjedhja e kalifit në Sekifa, viti 11h, 3. Ndodhia e Devesë në muajin Xhumadel Ahireh, viti 36h; 4. Ndodhi e Siffinit në Safer të vitit 37h; 5. Rënia dëshmor e Aliut, radijAllahu anhu, në Ramazan të vitit 40h; 6. Vdekja e Hasan ibën Aliut radijAllahu anhu, në vitin 49h; 7. Rënia dëshmor e Husejn ibën Aliut, radijAllahu anhu, në Kerbela në muajin Muharem të vitit 61.

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT ﷺ DHE FAMILJES SË EBU BEKRIT

- ALLAHU KA THËNË: ***"MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALLAHUT, NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE."***
- PO ASHTU KA THËNË: ***"THUAJ: "NUK JU KËRKOJ PËR KËTË KURRFARË SHPËRBLIMI, PËRVEÇ SE DASHURISË NDAJ TË AFËRMVE."***
- KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE, SE FAMILJA FISNIKE DHE SAHABËT JANË NJË, I EMËRTOJNË BIJTË E TYRE ME EMRAT E NJËJTË, KRUSHQITË MES TYRE VAZHDOJNË SI PARA ASHTU EDHE PAS NGJARJEVE TË GRINDJES QË REGJISTROI HISTORIA. KREJT KJO THEKSON VAZHDIMËSINË E RAPORTIT TË NGROHTË MES FAMILJES FISNIKE DHE SAHABËVE, TABIINËVE DHE ATYRE QË PASUAN. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!




LEXUESI I NDERUAR QË MEDITON MUND TË VËREJË SE NË TË GJITHA KËTO GJASHTË KRUSHQI TË BEKUARA BURRAT ISHIN NGA FAMILJA FISNIKE, KURSE GRATË NGA FAMILJA E EBU BEKRIT. ME QARTËSINË MË TË MADHE KJO TREGON PËR RAPORTIN E AFËRT MES ATYRE NË PËRGJITHËSI DHE SIDOMOS KUR MERRET PARASYSH SE SHUMICA E KËTYRE MARTESAVE NDODHËN PAS NGJARJEVE TË GRINDJES.

**NGJARJE TË RËNDËSISHME NË HISTORINË ISLAME:**

1. VDEKJA E PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, NË VITIN 11H;
2. ZGJEDHJA E KALIFIT NË SEKIFA, VITI 11H,
3. NDODHIA E DEVESË NË MUAJIN XHUMADEL AHIREH, VITI 36H;
4. NDODHI E SIFFINIT NË SAFER TË VITIT 37H;
5. RËNIA DËSHMOR E ALIUT, RADIJALLAHU ANHU, NË RAMAZAN TË VITIT 40H;
6. VDEKJA E HASAN IBËN ALIUT RADIJALLAHU ANHU, NË VITIN 49H;
7. RËNIA DËSHMOR E HUSEJN IBËN ALIUT, RADIJALLAHU ANHU, NË KERBELA NË MUAJIN MUHAREM TË VITIT 61.

- SHENJIMI ME 1B, 1G DERI NË GJASHTË TREGON NUMRIN E MARTESAVE MES KËTYRE DY FAMILJEVE DHE KUSH ME KË U MARTUA. ME B ALUDOHET BURRI DHE ME G GRUAJA.

- KËTO KRUSHQI I KANË VËRTETUAR DIJETARËT: EL-MUFID NË LIBRIN E TIJ EL-IRSHAD, FQ.270; MUHAMED EL-A'LEMI EL-HAIRI NË LIBRIN TERAXHUMU E'LAMI NISA, FQ.278; IBNU ANBE NË LIBRIN UMDETU TALIB, FQ.225; IBËN TAKTAKI NË LIBRIN EL-ESILI, FQ.149; MUSAB EZ-ZUBEJRI NË LIBRIN NESEBU KURAJSH.

QARTËSIMI I PESTË

## KRUSHQITË MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM DHE FAMILJES SË EBU BEKRIT, RADIJALLAHU ANHUM

Në këtë pjesë paraqesim gjashtë krushqi mes Familjes së Shtëpisë Profetike dhe familjes së Ebu Bekrit, radijAllahu anhu. Krushqia më e ndershme ishte ajo e Muhamedit, alejhi salatu ue selam, me të sinqertën, Aishen, radijAllahu anha, një vit para hixhretit dhe hyrja dhëndër në vitin 2h. Ajo mbeti grua e tij deri në vdekjen e tij, por a mbaroi kjo lidhje me aq? Assesi, ja që edhe nipi i të Dërguarit dhe lulja e tij, Hasani – në disa burime thuhet Husejni – u martua me mbesën e Ebu Bekrit, Hafsën, bijën e Abdurrahmanit. (Kjo u shënua në librin *Ensabul Eshraf,* 1/381, të El-Beladhiri dhe në librin *El-Muhbir,* fq. 448, të Ibën Habibit.)

Pastaj, nga nipat e Hasanit ishte Musa el-Xheuni, biri i Abdullah el-Mahdit, e ky biri Hasan el-Muthenna, që u martua me Selemen, bijën e Muhamed ibën Talha ibën Abdullah ibën Abdurrahman ibën Ebi Bekër es-Siddikut. (*Ensabul Eshraf,* 1/407; *Nesebu Kurajsh,* 1/20; *Ensabu Talibin* nga El-Fahri 1/36 dhe *Umdetu Talib,* 113.)

Sa i përket shtëpisë së Husejnit, radijAllahu anhu, ishte Muhamed el-Bakir, i cili diku në vitin 80h u martua me Ummu Ferua, bijën e el-Kasim ibën Muhamedit për të lindur nga ky çift Xhafer es-Sadikun (për këtë pajtohen të gjitha burimet).

Gjithashtu Is'hak ibën Abdullah ibën Muhamed ibën Alij ibën Husejn martohet me Kulthumen, bijën e Ismail ibën Abdurrahman ibën Kasim ibën Muhamed ibën Ebi Bekër (*Nesebu Kurajsh,* 1/24).

Kurse nga shtëpia e Xhafer Tajjarit ishte Is'hak ibën Abdul-

lah ibën Xhafer ibën Talib që u martua me Ummu Hakim, bijën e el-Kasim ibën Muhamed ibën Ebi Bekër, pra, motrën e Ummu Feruas. Kështu i bie që Ummu Hakim të jetë tezja e Xhafer es-Sadikut (*Esh-Shexheratul Mubarakah* nga Fahr Razi).

Në këtë fakt bëhet më se e qartë:

- Se shumica e martesave kanë ndodhur pas vdekjes së Ebu Bekrit, prandaj themi prerë se nuk ndodhën për shkak të ndonjë pozite politike, ekonomike etj., por vetëm për hir të dashurisë dhe respektit që ekzistonte mes këtyre dy shtëpive fisnike.

- Burrat që të gjithë ishin nga Familja Fisnike Profetike, ndërsa bashkëshortet nga familja e Ebu Bekrit. Dihet mirëfilli se inicimi i martesës ndodh nga ana e meshkujve drejtuar femrave, pra preferenca e Familjes Profetike në këtë drejtim ishte e qartë.

- Vazhdimi i këtyre krushqive pas ndodhive të ndryshme (Sekife, Siffin, Xhemel – Deveja, Kerbela...) është fakt i qartë se umeti në përgjithësi dhe Familja Fisnike i tejkaloi ato mospajtime, edhe pse disa orientalistë i zmadhojnë. Ndërkohë, ka shumë gabime historike të qarta që janë trilluar për të stërzmadhuar armiqësinë mes epokës profetike dhe asaj të kalifëve të drejtë, me qëllimin e shkaktimit të grindjeve dhe mbjelljes së mospajtimeve nga të cilat umeti nuk do të korrë asgjë përveçse gjemba.

# THËNIA E IMAM XHAFER ES-SADIKUT رضي الله عنه

## “Ebu Bekri më ka lindur dy herë.”

**Lindja e parë:** Nga ana e nënës së tij Ummu Ferua, bija e el-Kasim ibën Muhamed ibën Ebi Bekër es-Siddikut.

**Lindja e dytë:** Nga ana e gjyshes së tij Esma, bija e Abdurrahman ibën Ebi Bekër es-Siddikut.




* ALLAHU KA THËNË: **“MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALLAHUT, NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE.”** PO ASHTU KA THËNË: **“THUAJ: “NUK JU KËRKOJ PËR KËTË KURRFARË SHPËRBLIMI, PËRVEÇ SE DASHURISË NDAJ TË AFËRMVE”.**

* KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE SE FAMILJA FISNIKE DHE SAHABËT JANË NJË, I EMËRTOJNË BIJTË E TYRE ME EMRAT E NJËJTË, KRUSHQITË MES TYRE VAZHDOJNË SI PARA ASHTU EDHE PAS NGJARJEVE TË GRINDJES QË REGJISTROI HISTORIA NDËRKOHË . KJO THEKSON VAZHDIMËSINË E RAPORTIT TË NGROHTË MES FAMILJES FISNIKE DHE SAHABËVE, TABIINËVE DHE ATYRE QË PASUAN. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!

* UMDETU TALIB FI NESEBI ALI EBI TALIB NGA IBËN ANBEH, FQ. 345; KESHFUL GUMME FI MA’RIFETIL EIMMEH NGA EL-ERBILI, 2/347; EL-ESILI FI ENSABI TALIBIN NGA IBËN TAKTAKI, FQ. 149; TEHDHIBUL KEMAL NGA EL-MIZZI, BIGORAFIA NR. 950; TEHDHIBU TEHDHIB NGA IBËN HAXHER ASKALANI; EL-KASHIF NGA DHEHEBIU, BIOGRAFIA NR. 798.

* KËTO U VERIFIKUAN NË SHUMË BURIME, PREJ TYRE: KESHFUL GUMME I EL-ERBILI, 2/347, BOTIMI DARUL EDVAË – BEJRUT.

**NGJARJE TË RËNDËSISHME NË HISTORINË ISLAME:** 1. VDEKJA E PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, NË VITIN 11H; 2. ZGJEDHJA E KALIFIT NË SEKIFA, VITI 11H, 3. NDODHIA E DEVESË NË MUAJIN XHUMADEL AHIREH, VITI 36H; 4. NDODHI E SIFFINIT NË SAFER TË VITIT 37H; 5. RËNIA DËSHMOR E ALIUT, RADIJALLAHU ANHU, NË RAMAZAN TË VITIT 40H; 6. VDEKJA E HASAN IBËN ALIJUT RADIJALLAHU ANHU, NË VITIN 49H; 7. RËNIA DËSHMOR E HUSEJN IBËN ALIUT, RADIJALLAHU ANHU, NË KERBELA NË MUAJIN MUHAREM TË VITIT 61H.

QARTËSIMI I GJASHTË:

# "EBU BEKRI MË KA LINDUR DY HERË."

Afrohu, të të tregoj një çudi!

Xhaferi, i biri i Muhamed ibën Ali ibën Husejn ibën Ali ibën Ebi Talibit, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre, i cili gëzon nofkën es-Sadik (i sinqerti), mburret me gjyshin e parë Ebu Bekrin, tek i cili i arrin gjenealogjia nëpërmjet nënës Ummu Ferua, bija e dijetarit të banorëve të Medinës, El-Kasim ibën Muhamed ibën Ebi Bekër es-Siddikut. Kjo është lindja e parë.

Kurse nëna e saj (e Ummu Feruasë) ishte Esmaja, bija e Abdurrahman ibën Ebi Bekër es-Siddikut dhe kjo është lindja e dytë. A do t'i kishte hije Imam Xhaferit të mburret me njerëz jo të mirë?!

Çka e shtyu Muhamed el-Bakirin të martohet Ummu Feruanë?

A nuk po vërejmë o lexues i nderuar se kjo krushqi u lidh rreth shtatëdhjetë vite pas vdekjes së Ebu Bekrit? Nuk ekzistonte më asnjë interes politik apo ndonjë lakmi ekonomike, por vetëm dashuria, respekti dhe përzgjedhja se me kë të ndahet shtrati.

Realisht dhe ndodhi, lindi një imam dhe çfarë imami ishte! Xhafer es-Sadik!

Ai ka përcjellë transmetime që janë të shënuara në *Sahih Muslim* dhe në *Katër Sunenet* përveç asaj se ishte shumë i njohur në jurisprudencën islame dhe në dituri në përgjithësi.

Si të mos jetë kur baba kishte Muhamed el-Bakirin, dajë kishte juristin e Medinës, El-Kasim ibën Muhamedin, u lind dhe vdiq në djepin e diturisë – Medinën Profetike – e cila qe e stolisur me dije dhe dijetarë!

Ka përcjellë mbi **565** transmetime në librat e hadithit

# IMAM XHAFER ES-SADIKU

**“Pasha Allahun, ne nuk jemi përveçse robër të Atij që na krijoi dhe na zgjodhi, nuk kemi fuqi për dëm e as dobi, nëse na mëshiron, na mëshiron me mëshirën e Tij e nëse na ndëshkon, me mëkatet tona. Për Zotin, kundër Allahut nuk mund të kemi asnjë argument e as para Tij ndonjë arsyetim.”**

## NGA FJALËT E TIJ

* “JINI DËSHMITARË SE UNË JAM PREJ BIJVE TË PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, POR NUK KAM ASNJË ARSYETIM TEK ALLAHU. NËSE I BINDEM, AI MË MËSHIRON E NËSE E KUNDËRSHTOJ, DO TË MË NDËSHKOJË ME NDËSHKIM TË RREPTË.”

* “PASHA ALLAHUN, NUK DIMËI PËR GJITHÇKA QË NA PYESIN, TJETËRKUSH ËSHTË MË I DITUR.”

* “E MIRA NUK ËSHTË E PLOTË PËRVEÇSE ME TRI: SHPEJTËSI, ZVOGËLIM DHE FSHEHJE.”

* “NUK KA ZAHIRE MË TË MIRË SE DEVOTSHMËRIA, NUK KA GJË MË TË BUKUR SE HESHTJA, NUK KA ARMIK MË TË DËMSHËM SE INJORANCA DHE NUK KA SËMUNDJE MË TË RËNDË SE RRENA.”

## PASARDHËSIT E TIJ ME EMRIN AISHE

*AISHE, BIJA E XHAFER ES-SADIKUT

*AISHE, BIJA E MUSA EL-KADHIM IBËN XHAFER ES-SADIKUT

*AISHE, BIJA E ALI ER-RIDA IBËN MUSA EL-KADHIMIT

*AISHE, BIJA E XHAFER IBËN MUSA EL-KADHIMIT

*AISHE, BIJA E ALI EL-HADI IBËN MUHAMED EL-XHEVADIT




## DASHURIA E TIJ NDAJ SAHABËVE

* KA THËNË: “SHOKËT E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT ISHIN DYMBËDHJETË MIJË, TETË MIJË NGA MEDINA, DY MIJË NGA MEKA DHE DY MIJË PREJ TË LIRUARVE. NUK ËSHTË PARË NË MESIN E TYRE NDONJË KADERIJ, AS MURXHI, AS HARURIJ, AS MU'TEZILIJ E AS NDONJË APOLOGJET...”.

* KA THËNË: “NUK SHPRESOJ NGA NDËRMJETËSIMI I ALIUT, RADIJALLAHU ANHU, DIÇKA MË SHUMË SESA SHPRESOJ NGA NDËRMJETËSIMI I EBU BEKRIT, RADIJALLAHU ANHU, I CILI MË LINDI DY HERË”.

* KA THËNË: “SI MUND TA FYEJË NJERIU GJYSHIN E TIJ? EBU BEKRI ËSHTË GJYSHI IM, MOS MË ARRIFTË SHEFATI I MUHAMEDIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, NË DITËN E KIAMETIT PO QË SE NUK I DUA ATA TË DY DHE PO QE SE NUK DISTANCOHEM NGA ARMIQTË E TYRE – EBU BEKRIT DHE OMERIT”.

* U PYET NJËHERË PËR EBU BEKRIN DHE OMERIN E THA: “TI PO MË PYET PËR DY BURRA QË VEÇSE KANË SHIJUAR NGA USHQIMET E XHENETIT.”

* KA THËNË: “ALLAHU U LARGOFTË NGA AI QË LARGOHET PREJ EBU BEKRIT DHE OMERIT!”

**BURIMET:**


(1) Tesdidul Usul nga El-Kami, 2/76, dhe Biharul Enuar nga El-Mexhlisi (25/289); (2) El-Hisal nga El-Kami, 2/639-640, dhe Biharul Enuar nga El-Mexhlisi, 22/305; (3) Fedailu Sahabeh nga Darekutni, 57, dhe Sherh Usuli Sunne nga Lalekai, 7/1380; (4) Fedailu Sahabeh nga Imam Ahmedi, 1/214-215, dhe Fedailu Sahabeh nga Darekutni, 56; (5) Fedailu Sahabe nga Darekutni, 96, dhe Sijeru Alami Nubela nga Dhehebiu, 6/259; (6) Es-Sunne nga Abdullah ibën Ahmed, 2/557, dhe Fedailu Sahabe nga Darekutni, 87; (7) Rixhal nga El-Keshi, 299, dhe Biharul Enuar nga El-Mexhlisi, 25/290; (8) Tarihul Kebir nga Ibën Ebi Hajtheme, 437, dhe Sherh Usulil Itikad nga Lalekai, 8/1485; (9) Hiljetul Eulija nga Ebu Nuajm, 3/198, dhe Shuabul Iman nga Bejhekiu, 15/312; (10) Hiljetul Eulija nga Ebu Nuajm, 3/196, dhe Tarihul Islam nga Dhehebiu, 7/92; (11) Nurul Ebsar nga Sheblenxhi, 287, (titulli: Nga bijat e Xhafer es-Sadik: Aishe) dhe A'lamu Nisa nga Kehale, 3/132; (12) Keshful Gumme, 3/29 (titulli: Nga bijtë e Musa el-Kadhim: Omer, Hamza dhe Aishe); (13) Keshful Gumme, 3/60, (titulli: Nga bijat e Alij ibën Musa: Aishe); (14) El-Mexhdi, 301 (titulli: Nga bijat e Xhafer ibën Musa: Aishe); (15) El-Irshad, 334 (titulli: Aishe, bija e Alij el-Hadi); (16) Tarihul Kebir nga Buhariu, 2/198; El-Xherhu ue Tadil nga Ibën Ebi Hatim, 2/487; Tehdhibul Kemal nga El-Mizzi, 2/277; Sijeru Alami Nubela nga Dhehebiu, 6/255; Tehdhibu Tehdhib nga Ibën Haxher, 1/310, dhe Tarihul Islam nga Dhehebiu, 7/88; (17) Transmetime janë në librat e hadithit si vijon: Sahihu Muslim, 23, Muvetta, 10, Musned Ahmed, 36, Sunen Ebu Davud, 13, Sunen Nesai, 44, Sunen Tirmidhi, 20, Sunen Ibën Maxhe, 19, Sunen Darimi, 7, Sunen Kubra nga Nesai, 58, Sahih Ibën Huzejme, 35, Sahih Ibën Hibban, 20, Mustedrak Hakim, 45, Sunen Kubra nga Bejheki, 179, dhe Miuxhem Kebir nga Taberani, 56.

QARTËSIMI I SHTATË:

## IMAM XHAFER ES-SADIKU

Ebu Abdullah Xhafer es-Sadiku, i biri i Muhamed el-Bakir ibën Ali Zejnul Abidin ibën Husejn ibën Ali ibën Ebi Talibit, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre, është një ndër imamët e mëdhenj dhe prej zotërinjve të Shtëpisë Fisnike. Mori nofkën es-Sadik (i sinqertë) për shkak se ishte i vërtetë çdoherë kur fliste. Mirësia e tij është më e njohur sesa të flitet për të.

Lindi në vitin 80h, kurse në disa burime thuhet se lindi ditën e martë para lindjes së diellit në ditën e tetë të Ramazanit të vitit 83h. Ndërroi jetë në muajin Sheval të vitit 148h në Medinë, u varros në varrezat Bekië afër babait të tij Muhamed el-Bakir, gjyshit të tij Ali Zejnul Abidin dhe xhaxhait të gjyshit të tij Hasan ibën Aliut, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre! Sa varr fisnik dhe me nder!

Në faktin e kaluar paraqitëm lidhjen gjenealogjike të Xhafer Sadikut me Ebu Bekër Siddikun, i cili qe gjyshi i tij për nga nëna Ummu Ferua, bija e El-Kasim ibën Muhamed ibën Ebi Bekër, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre!

Kurse te ky fakt po paraqesim lidhjen e tij arsimore me dijetarët e mëdhenj bashkëkohorë të kohës së tabiinëve nga të cilët mori dije dhe e përcolli atë, duke treguar kësisoj vlerën e kërkimit të diturisë dhe transmetimit nga Pejgamberi, alejhi salatu ue selam, si dhe duke aluduar se nderi i pozitës dhe gjenealogjisë konsiston në arritjen e kulmit me dituri dhe transmetim. Këtu solla edhe diçka prej lavdive që ai shprehu për sahabët me shprehjet e tij të ëmbla, në veçanti lidhur me dy burrat Ebu Bekrin dhe Omerin, radijAllahu anhuma. Po ashtu, solla edhe disa prej urtësive të përhapura që ai tha, në veçanti lidhur me teuhidin dhe njësimin e Allahut në synim dhe lutje.

Gjithashtu kam gjetur se ai ka mbi 565 transmetime në librat e ndryshëm të hadithit, e cila është shenjë e qartë se tubuesit e haditheve dhe gjurmëve i dhanë rëndësi të madhe transmetimit nga ai, Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT ﷺ DHE FAMILJES SË EL-FARUKUT OMER IBËN HATTABIT




**ME RËNDËSI:** KY TRUNG NUK PARAQET VETËM NJË PJESË TË KRUSHQIVE DHE JO TË GJITHA.

ALLAHU KA THËNË: "MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALLAHUT NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE". KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE PËR RAPORTET E AFËRTA MES SHTËPISË FISNIKE DHE SAHABËVE DHE PASARDHËSVE TË TYRE NDËR GJENERATA. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!


**BURIMET MË TË RËNDËSISHME:**
*EL-MEARIF NGA IBËN KUTEJBE, FQ.232; *TABEKATUL KUBRA NGA IBËN SADI, 3/332; *UESAILU SHIA NGA HURR EL-AMILI, 20/240; *NESEBU KURAJSH NGA EZ-ZUBEJRI, 25; *UMDETU TALIB, 344; *ENSABUL ESHRAF NGA EL-BELADHIRI, 1/474; *MUHTELEFU SHIA NGA EL-HILJI, 2/308; *EL-MEBSUT NGA ET-TUSI, 4/270; *EL-ESILI NGA IBËN TAKTAKI, 58; *BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 44/168 DHE 45/329.

QARTËSIMI I TETË:

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, DHE FAMILJES SË EL-FARUKUT OMER IBËN HATTABIT, RADIJALLAHU ANHU

Nga librat e biografive dhe prejardhjeve mësojmë për tri krushqi mes familjes së Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, dhe familjes së Omerit, radijAllahu anhu. Më e njohura dhe më madhështorja ndër to është ajo mes vetë Muhamedit, alejhi salatu ue selam, dhe Hafsës, nënës së besimtarëve, radijAllahu anha, e cila mbeti grua e tij deri në fund. Ajo martesë e bekuar u lidh në vitin 3h pasi ra shehid bashkëshorti i Hafsës në Betejën e Bedrit.

Krushqia e dytë u lidh kur u martua Omeri, radijAllahu anhu, me bijën e Aliut dhe Fatimes, radijAllahu anhuma, me Ummu Kulthumen, pra, mbesën e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam. Ajo lindi duke qenë gjallë Profeti, alejhi salatu ue selam, kurse u martua me Omerin në vitin 20h. (lexo faktin: Unë jam djalë i dy kalifëve).

Kur e vranë babanë e saj, Aliun, radijAllahu anhu, pati thënë: “Si do t’ia bëj me namazin e sabahut tash e tutje?!”

Kishte për qëllim se burri i saj Omeri u vra nga dora e idhujtarit Ebu Lulu gjatë namazit të sabahut, kurse tani edhe babai i saj, Aliu u vra nga dora e kriminelit Abdurrahman ibën Mulxhim, gjithashtu gjatë namazit të sabahut. Pastaj deshi Allahu që edhe djali i saj Zejdi, biri i Omerit, të vdiste gjatë namazit të sabahut, madje edhe vetë ajo së bashku me të birin dhanë shpirt për një çast, saqë nuk u dit se kush prej kujt të trashëgojë! (*Rijadul Mesail* nga Tabatabai, 12/664, *Mustenedu Shia* nga Neraki, 19/452, dhe *Tarihu Dimeshk*, biografia e Ali ibën Ebi Talibit).

Pasi ra dëshmor Omeri, radijAllahu anhu, ajo u martua me Auf ibën Xhafer ibën Ebi Talibin, pastaj ndërroi jetë edhe Aufi dhe u martua me vëllanë e tij Muhamedin, pastaj ndërroi jetë edhe Muhamedi dhe ajo u martua me vëllanë e tij Abdullah ibën Xhaferin dhe ndër kurorën e tij Ummu Kulthumja, radijAllahu anha, ndërroi jetë. Ajo thoshte: “Po turpërohem nga vjehrra ime Esma bint Umejs, i vdiqën dy djem me mua e po kam frikë për të tretin”. Pra, ndërroi jetë tek i treti ndërsa nuk pati asnjë lindje nga këta. (E ka përmendur Ibën Haxheri në librin *El-Isabeh* në biografinë e Ummu Kulthumes).

Kurse krushqia e tretë ndodhi në gjeneratën e pestë, pra në nipat e nipave, mes Hasen ibën Ali ibën Ali Husejn ibën Ali ibën Ebi Talib dhe mbesës së nipit të Omerit, radijAllahu anhum, Xhuvejrijes, bijës së Halid ibën Ebi Bekër ibën Abdullah ibën Omerit. Kështu theksuan edhe një herë afërsinë dhe vëllazërinë që patën paraardhësit e tyre.

# ZEJD IBËN OMER IBËN HATTABI رحمه الله KA THËNË:

# "UNË JAM BIR I DY KALIFËVE"




**ALLAHU KA THËNË:** *"MUHAMEDI ËSHTË DËRGUAR I ALLAHUT, NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE".* **(FET'H: 29).**

**KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE PËR RAPORTET E AFËRTA MES OMER IBËN HATTABI DHE ALI IBËN EBI TALIBIT, RADIJALLAHU ANHUMA. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!**

*EL-ESILI NGA IBËN TAKTAKI, FQ.58;
*BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 78/382;
*EL-BIDAJE UE NIHAJE NGA IBËN KETHIRI;
* TARIHUL ISLAM NGA DHEHEBIU, TE NGJARJET E VITIT 45H;
*TARIHU DIMESHKU NGA IBËN ASAKIR, BIOGRAFIA E ZEJD IBËN OMER IBËN HATTABIT;
*EDH-DHERIA NGA AGA BEZRAK TAHRANI, 5/184,
*A'JANU SHIA NGA MUHSIN EMIN, 3/486;
*RIJADUL MESAIL NGA TABATABAI, 12/664;
*SIJERU ALAMI NUBELA NGA DHEHEBIU, 3/502;
*KESHFU LITHAM NGA FADIL EL-HINDI, 9/525;
*KIFAJETUL AHKAM NGA SEBZAVI, 2/879;
* EL-UAFI FIL UEFEJAT NGA ES-SAFEDI, 15/23;
*UESAILU SHIA NGA HUR EL-AMILI, 26/314;
*MUHTELEFU SHIA NGA EL-HILJI, 2/308.

QARTËSIMI I NËNTË:

## "UNË JAM BIR I DY KALIFËVE."

Zejd ibën Omer ibën Hattabi mburrej me dy prindërit e tij, Omerin dhe Aliun radijAllahu anhuma, kur thoshte "Unë jam bir i dy kalifëve", sepse nëna e tij ishte Ummu Kulthumja, bija e Aliut dhe Fatimes, radijAllahu anhuma.

Hakimi shënon me zinxhir të vazhdueshëm nga Xhafer es-Sadiku e ai nga babai i tij Muhamed el-Bakir se Omer ibën Hattabi kur shkoi për të kërkuar dorën e Ummu Kulthumes tek Aliu i tha: -Ma jep atë për nuse! Aliu tha: -Unë po e ruaj për djalin e vëllait tim, Xhaferin. Omeri tha: -Martoje me mua, sepse pasha Allahun askush nga njerëzit nuk pret prej saj atë çfarë pres unë. Aliu u pajtua dhe Omeri shkoi te muhaxherët dhe tha: -A nuk më uroni? -Ç'të të urojmë o udhëheqës i besimtarëve? Tha: -Ma uroni Ummu Kulthumen, bijën e Aliut dhe bijën e Fatimes, bijës së të Dërguarit të Allahut. Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: *'Krejt lidhjet dhe krushqitë do të këputen Ditën e Kiametit, përveç ato çka janë nëpërmjet meje dhe prejardhjes sime'*, ndaj desha që mes meje dhe Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, të kemi si krushqi edhe lidhje familjare."

Ummu Kulthumja lind nga Omeri dy fëmijë, Zejdin dhe Rukajjën. Zejdi nuk pati jetë të gjatë pasi vdiq i ri, në vitin 45h. Ai u vra si rezultat i një konflikti që ndodhi mes dy familjeve të kushërinjve të tij nga fisi Benu Adij. Ai doli për t'i pajtuar dhe u godit në kokë gabimisht nga dikush që as nuk u mor vesh se kush ishte, pastaj nuk zgjati shumë derisa ai së bashku me të ëmën, Ummu Kulthumen, radijAllahu anhuma, ndërruan jetë në një çast.

Xhenazen ia fali vëllai Abdullah ibën Omeri dhe pas tij gjendeshin dy dajallarët e tij, Hasani dhe Husejni, radijAllahu anhum. (*Tarih Dimeshk* nga Ibën Asakir, biografia e Zejd ibën Omerit.)

Kurse Rukajja, bija e Omerit dhe Ummu Kulthumes, u martua me Ibrahim ibën Nuajm ibën Neham, një nga fisi Benu Adij. (*El-Isabeh* nga Ibën Haxheri, biografia e Ibrahim ibën Nuajm ibën Neham.)

# OSMANI ﷿ NË SHTËPINË PROFETIKE




**BURIMET PËR KËTË TRUNG:**

Të gjithë librat e biografive dhe të historisë islame, si p.sh. *Tarihul Islam nga Dhehebiu; Biharul Enuar nga El-Mexhlisi, 22/201; El-Uafi bil Uefejat nga Es-Safedi, 20/28; Tarih nga El-Jakubi, 2/162.




Ky diagram sqaron dukshëm thellësinë e lidhjes së Osmanit, radijAllahu anhu, me shtëpinë e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, pa si:

1. Prejardhja e të dyve takohet tek Abdumenaf ibën Kusaj ibën Kilabi, gjyshi i tretë i Pejgamberit, alejhi salatu ue selam.
2. U bë dy herë krush Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, me dy bijat e tij Rukajjen dhe Ummu Kulthumen, radijAllahu anhuma.
3. Erva bija e Kurejzit, radijAllahu anha, është nëna e Osmanit, radijAllahu anhu, kurse nëna e saj është tezja e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, pra, Ummu Hakim Bejda bija e Abdulmutalibit, binjakja e Abdullahut, babait të Pejgamberit, alejhi salatu ue selam.

QARTËSIMI I DHJETË:

## OSMANI, RADIJALLAHU ANHU, NË SHTËPINË PROFETIKE

Ai qe udhëheqës i besimtarëve, i treti prej kalifëve të drejtë e të mençur, një nga dhjetë të përgëzuarit me xhenet, një nga muslimanët e parë, bëri dy hixhrete – në Etiopi dhe në Medinë, ishte zotëri gjatë injorancës dhe po ashtu në Islam dhe për hir të tij ndodhi Besëlidhja Riduan. Vlerat e tij janë më shumë se ç'mund të përmenden.

Prania e Osmanit në shtëpinë profetike vërehet nëpërmjet pesë lidhjeve që vijojnë:

1. Ai është kushëri i Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, sepse takohen me gjenealogji tek Abdumenaf ibën Kusaj, i cili qe gjyshi i tretë i Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, kurse Osmani ishte biri i Affan ibën Ebil As ibën Umejje ibën Abdushems ibën Abdumenafit.

2. Erua, bija e Kurejzit, është nëna e Osman ibën Affanit, radijAllahu anhuma, kurse nëna e saj ishte Bejdaja, bija e Abdulmutalibit, domethënë motra e Abdullahut, prindit të Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, madje binjakja e tij, sepse u lindën nga e njëjta shtatzëni.

3. nëna Kurejzi takohet gjithashtu me Profetin, alejhi salatu ue selam, tek Abdumenafi dhe kështu Osmani bashkëndan me Profetin, alejhi salatu ue selam, gjyshin e tyre Abdumenafin për nga prejardhja e babës dhe e nënës.

4. Pastaj pati nderin e pakrahasueshëm dhe mirësinë e paçmueshme kur Osmani u martua me Rukajjen, radijAllahu anha, para hixhretit; bëri hixhret me të në Etiopi, pastaj në Medinë; u kujdes për të kur ajo u sëmur nga fruthi gjatë Betejës së Bedrit sepse ashtu sugjeroi Pejgamberi, alejhi salatu ue selam.

5. Kur vdiq Rukajja, radijAllahu anha, i Dërguari, alejhi salatu ue selam, i dha për nuse Osmanit bijën tjetër, Ummu Kulthumen, radijAllahu anha, e cila mbeti e martuar me të deri në vdekje, në vitin 9h.

# KRUSHQITË MES FAMILJES PROFETIKE ﷺ DHE FAMILJES SË OSMAN IBËN AFFANIT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE!




**BURIMET MË TË RËNDËSISHME:**

TARIH DIMESHK NGA IBËN ASAKIR; ET-TABEKATUL KUBRA NGA IBËN SAD; XHEMHERETU ENSABIL ARAB NGA IBËN HAZMI; NESEBU KURAJSH NGA ZUBEJR IBËN BEKKAR; UMDETU TALIB NGA IBËN ANBE; ENSABUL ESHRAF NGA EL-BELADHIRI; -TARIHUL JA'KUBI; -MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FERAXH EL-ESFEHANI; -MUNTEHAL AMAL NGA ABBAS EL-KAMI; -ELMUHBIR NGA IBËN HABIB; -ELESILI NGA IBËN TAKTAKI; -KESHFUL GUMME NGA EL-ERBILI.

**VINI RE:** KY TRUNG PARAQET DISA KRUSHQI DHE GJENEALOGJI, POR JO TË GJITHA!

ALLAHU KA THËNË: "MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALLAHUT NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE".
KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE PËR RAPORTET E AFËRTA MES SHTËPISË FISNIKE DHE SAHABËVE DHE SE KRUSHQIA MES TYRE PAS NGJARJEVE TË FITNES VAZHDOI SIKURSE MË PARË, ÇKA DËSHMON PËR RAPORTET E TYRE TË NGROHTA PËRGJATË HISTORISË. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!

PËRPUTHJET NË NUMRA DHE FORMA ALUDOJNË PËR MARTESËN MES KËTYRE PERSONALITETEVE NGA FAMILJA PROFETIKE DHE AJO E OSMANIT, RADIJALLAHU ANHU.

QARTËSIMI I TREMBËDHJETË

# KRUSHQITË MES FAMILJES PROFETIKE DHE FAMILJES SË OSMAN IBËN AFFANIT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE!

Në këtë qartësim vërehen qartas tetë krushqi mes Familjes Profetike dhe familjes së Osmanit, radijAllahu anhu, ku mes tjerash vërehen edhe këto:

1. Osmani me familjen e tij për nga prejardhja takohet me prejardhjen e ndershme profetike në gjyshin e tretë të Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, te Abdumenafi.
2. Martesa e Osmanit, radijAllahu anhu, me bijat e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, Rukajje dhe Ummu Kulthum, radijAllahu anhuma.
3. Këto krushqi vazhduan pesë gjenerata me radhë; Osmani, djali i tij Ebani, nipi e tij Mervani, Abdullahu dhe Zejdi e po ashtu edhe mbesa e Osmanit, Rukajja.
4. Nga ato, dy martesa ishin nga shtëpia e Hasanit dhe tri të tjera nga shtëpia e Husejnit, radijAllahu anhuma. Është më se e ditur se martesat forcojnë lidhjet familjare dhe raportet shoqërore. Atu fuqizohen edhe më kur martesat shtohen. Nga këto krushqi çka mund të shohësh tjetër përveçse mbështetje të edukatës që i Dërguari, alejhi salatu ue selam, i dha familjes dhe sahabëve. Madje, kjo u përcoll në bij dhe nipa.

Medito mirë... a ke dëshirë të bëhesh krushqi apo të bëhet me ty dikush që ka Islam apo moral të dyshimtë ose që mund të jetë armik potencial?!

Nëse ti nuk do, aq më shumë nuk do ta donin këtë Shtëpia Fisnike dhe sahabët.

# KRUSHQITË MES SHTËPISË FISNIKE DHE KUSHËRINJVE




KRUSHQIVE TË SHTËPISË FISNIKE ME OSMANIN DHE PASARDHËSIT E TIJ U DHAMË PËRPARËSI TA PARAQESIM NË TRUNG TË VEÇANTË PËR SHKAK TË RËNDËSISË DHE SASISË QË KA.

VINI RE: KY TRUNG PARAQET VETËM NJË PJESË TË KRUSHQIVE DHE PREJARDHJEVE, POR JO TË GJITHA!

**BURIMET MË TË RËNDËSISHME:**

TARIH DIMESHK NGA IBËN ASAKIR; ET-TABEKATUL KUBRA NGA IBËN SAD; XHEMHERETU ENSABIL ARAB NGA IBËN HAZMI; NESEBU KURAJSH NGA ZUBEJR IBËN BEKKAR; UMDETU TALIB NGA IBËN ANBE; ENSABUL ESHRAF NGA EL-BELADHIRI; -TARIHUL JA'KUBI; MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FERAXH EL-ESFEHANI;-MUNTEHAL AMAL NGA ABBAS EL-KAMI; -ELMUHBIR NGA IBËN HABIB;-ELESILI NGA IBËN TAKTAKI;-KESHFUL GUMME NGA EL-ERBILI.

- PËRPUTHJET NË NUMRA DHE FORMA ALUDOJNË PËR MARTESAT MES KËTYRE PERSONALITETEVE NGA PREJARDHJA E HASHIMIT DHE KUSHËRINJVE.

ALLAHU KA THËNË: "MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALLAHUT NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE".

KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE PËR RAPORTET E AFËRTA MES SHTËPISË FISNIKE DHE SAHABËVE DHE SE KRUSHQIA MES TYRE PAS NGJARJEVE TË FITNES VAZHDOI SIKURSE MË PARË, ÇKA DËSHMON PËR RAPORTET E TYRE TË NGROHTA PËRGJATË HISTORISË. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!

QARTËSIMI I KATËRMBËDHJETË

# KRUSHQITË MES SHTËPISË FISNIKE DHE KUSHËRINJVE

Ndoshta ky ishte qartësimi me material më të shumtë, edhe pse i ndamë në vete krushqitë e familjes së Osmanit, radijAllahu anhu. Nëpërmjet këtij qartësimi, lexues i nderuar, të shfaqen disa të vërteta:

1. Njerëzit e shtëpisë fisnike nuk qenë të izoluar nga shoqëria dhe kjo vërehet nëpërmjet këtyre martesave të shumta përgjatë gjeneratave të njëpasnjëshme.
2. Tre nga bijat e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, dolën nga Shtëpia Fisnike në shtëpinë e Kurejshëve, nëse llogarisim këtu edhe krushqitë me Osmanin, radijAllahu anhu.
3. Këtu shohim tetë krushqi me familjen e Osmanit, radijAllahu anhu; gjashtë krushqi me familjen e Mervan ibën Hakemit dhe katër krushqi me familjen e Ebu Sufjanit, radijAllahu anhu.
4. Prej tyre dymbëdhjetë krushqi u bënë me familjen e Alij ibën Ebi Talibit, radijallahu anhu, që u bënë të qarta nga ky qartësim dhe qartësimi i krushqive mes Shtëpisë fisnike dhe familjes së Osmanit, radijallahu anhu.
5. Shumica e këtyre krushqive kanë ndodhur pas ngjarjeve të fitnes (Siffini, Deveja, Kerbelaja).
6. Mes familjes së Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, dhe familjes së Ebu Sufjanit, radijAllahu anhu, pati katër krushqi, më fisnikja ndër to ishte martesa e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, me Ummu Habiben, pra, Ramla bija e Ebu Sufjanit, që njëherësh ishte bashkëshortja më e afërt e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, për nga gjaku.

# ZUBEJRI NË SHTËPINË PROFETIKE




**BURIMET** (TË GJITHË LIBRAT E BIOGRAFIVE, TRANSMETUESVE DHE TË HISTORISË, SI PËR SHEMBULL):

-SIJERU ALAMI NUBELA NGA DHEHEBIU, 1/43;
-EL-ISABEH NGA IBËN HAXHERI (BIOGRAFIA E ZUBEJRIT);
-EL-KAVAID UEL FEVAID NGA MUHAMED MEKKI EL-AMILI, 2/327;
-MUSTEDRAKATU ILMI RIXHAL NGA ALI NEMAZI ESH-SHAHRUDI, 3/418 (7175).




KY DIAGRAM PARAQET ME QARTËSI THELLËSINË E LIDHJES SË ZUBEJR IBËN AVVAMIT, NDIHMËTARIT TË PROFETIT, ALEJHI SALATU UE SELAM ME SHTËPINË FISNIKE, SEPSE AI QE:

1 – KUSHËRI I PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, PASI TAKOHEN TE GJYSHI I TYRE KUSAJ IBËN KILABI.

2 – DJALË I HALLËS PËR PEJGAMBERIN, ALEJHI SALATU UE SELAM, PRA, DJALË I SAFIJES BIJËS SË ABDULMUTALIBIT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ SAJ!

3 – DJALË I VËLLAIT TË ZONJËS DHE NËNËS SË BESIMTARËVE HADIXHE BINT HUVEJLID, RADIJALLAHU ANHA, E CILA QE GRUAJA E PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM.

QARTËSIMI I PESËMBËDHJETË

## ZUBEJRI NË SHTËPINË PROFETIKE

Zubejr ibën Avvam ibën Huvejlid ibën Esed ibën Abduluzza ibën Kusajj ibën Kilabi nga fisi Kurejsh, familja el-Esdi; kishte nofkën Ebu Abdullah dhe ishte një ndër ndihmëtarët e të Dërguarit të Allahut, alejhi salatu ue selam, dhe djalë i hallës së tij, Safijes bijës së Abdulmutalibit, radijAllahu anha. Ishte një nga dhjetë të përgëzuarit me xhenet dhe një prej gjashtë personave për konsultim që duhej të zgjidhnin kalifin e tretë. Nëna e tij e thërriste Ebu Tahir, me nofkën e vëllait të saj Zubejr ibën Abdulmutalibit, por ai zgjodhi nofkën me emër të djalit të tij Abdullah dhe me atë u bë i njohur, pra me Ebu Abdullah. Kur e pranoi Islamin ishte dymbëdhjetëvjeçar, por thuhet edhe se ishte tetëmbëdhjetëvjeçar.

Zubejr ibën Avvami, radijAllahu anhu, takohet me Shtëpinë Fisnike me disa lidhje familjare:

1. Takohen së bashku me të Dërguarin e Allahut te gjyshi i katërt, pra te Kusajj ibën Kilabi.
2. Nëna e tij Safije bint Abdulmutalib ibën Hashimi nga fisi Kurejsh dhe familja e Hashimit, radijAllahu anha, ishte halla e të Dërguarit, alejhi salatu ue selam, dhe motër për nga nëna dhe babai me Hamzain, radijAllahu anhu; kurse nëna e saj Haleh bint Uehb ishte teze e të Dërguarit, alejhi salat ue selam. Ajo në fillim qe martuar me Harith ibën Umejje, por ai vdiq e pastaj u martua me Avvam ibën Huvejlid ibën Esed ibën Abduluzzan, nga i cili lindi Zubejrin dhe Saibin. Ajo e pranoi Islamin dhe bëri hixhretin së bashku me djalin e saj Zubejrin dhe jetoi deri në kalifatin e Omerit, radijAllahu anhu.
3. Teze e tij qe nëna e besimtarëve dhe zonja e grave të xhenetit, Hadixheja radijAllahu anha, e cila ishte besimtarja e parë që pranoi Islamin.
4. Së këndejmi, themi se Fatimja bija e Pejgamberit, radijAllahu anha, qe bija e tezes së Zubejrit.

Duke u nisur nga këto të dhëna, marrim të drejtën ta themi me zë të lartë: Zubejri në Shtëpinë Fisnike!

# HASAN

## UDHËHEQËSI I BESIMTARËVE D

## LIDHJA E TIJ ME EBU BEKËR ES-SIDDIKUN رضي الله عنه

HASANI E ARRITI KALIFATIN E EBU BEKRIT, RADIJALLAHU ANHU, KUR ISHTE NËNTËVJEÇAR. NGA SHENJAT E DASHURISË SË EBU BEKRIT PËR HASANIN, RADIJALLAHU ANHU, ËSHTË AJO QË KA SHËNUAN BUHARIU NË SAHIHUN E TIJ NGA UKBE IBËN HARITHI: "EBU BEKRI E FALI IKINDINË, PASTAJ DOLI DHE DUKE ECUR PA HASANIN DUKE LUAJTUR ME FËMIJË DHE E MORI MBI SUPE DHE THA: -SAKRIFIKOFSHA BABANË TIM, KY I NGJAN PEJGAMBERIT E NUK I NGJAN ALIUT, NDËRSA ALIU QESHTE."

## LIDHJA E TIJ ME OMER EL-FARUKUN رضي الله عنه

HASANI, RADIJALLAHU ANHU, ARRITI KALIFATIN E OMERIT NDËRSA ISHTE NË MOSHËN NJËMBËDHJETËVJEÇARE DERI NË MOSHËN NJËZETENJËVJEÇARE. NGA SHENJAT E DASHURISË SË OMERIT, RADIJALLAHU ANHU, NDAJ HASANIT DHE VËLLAIT TË TIJ HUSEJNIT JANË:

1. PËR HASANIN DHE HUSEJNIN CAKTOI PAGESA TË NJËJTA SIKURSE PËR PJESËMARRËSIT NË BETEJËN E BEDRIT, PRA PËR SAHABËT E MËDHENJ, MADJE TË PARIT QË IU DHA NGA PREJA E PERSËVE ISHTE HASANI, PASTAJ HUSEJNI E PASTAJ SAHABËT E TJERË .
2. NJËHERË ISHIN SJELLË CA VESHJE NGA JEMENI, POR ASGJË NUK PËRSHTATESHIN PËR HASANIN DHE HUSEJNIN, KËSHTU QË OMERI DËRGOI FJALË NË JEMEN DERISA U SOLL VESHJE E PËRSHTATSHME PËR ATA TË DY, PASTAJ OMERI THA: "TANI JAM I QETË."
3. E KA DALLUAR HASANIN DHE HUSEJNIN NË DHURATA PËRPARA DJALIT TË VET ABDULLAHUT DHE ABDULLAHU NJËHERË I KISHTE THËNË: "PO U JEP PËRPARËSI ATYRE TË DYVE NDËRSA UNË JAM SHOQËRUAR ME PEJGAMBERIN DHE KAM BËRË HIXHRET, KURSE ATA JO." OMERI I THA: "HESHT, MOS TË PASTË NËNA! BABAI I TYRE ËSHTË MË I MIRË SE BABAI YT DHE NËNA E TYRE ËSHTË MË E MIRË SE NËNA JOTE."

## LIDHJA E TIJ ME OSMANIN DHUN NURAJN رضي الله عنه

HASANI, RADIJALLAHU ANHU, E ARRITI KALIFATIN E OSMANIT NDËRSA ME MOSHË KALOI TË TRIDHJETAT. PREJ SHENJAVE TË DASHURISË DHE RESPEKTIT QË AI KISHTE PËR KALIFIN E MIRË OSMAN IBËN AFFANIN ËSHTË SE HASANI QE NGA MBROJTËSIT MË TË THEKSUAR TË KALIFIT TË MUSLIMANËVE KUR REBELËT E RRETHUAN. HASANI NXORI DY SHPATA DHE ME TË DYJA LUFTONTE PËRNJËHERË EDHE PSE OSMANI KËRKOI QË SHPATAT T'I KTHEJË NË KËLLËF DHE TË IKTE TE BABAI, POR HASANI REFUZOI, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TIJ, DERISA U NXOR I PLAGOSUR.

## ASKETIZMI I TIJ PËR KALIF DHE PENGIMI I GJAKDERDHJES SË MUSLIMANËVE

U VËRTETUA HADITHI I PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM: "KY BIR I IMI ËSHTË ZOTËRI DHE SIGURISHT QË ME TË ALLAHU DO TË PAJTOJË DY GRUPE TË MËDHA TË MUSLIMANËVE." KY ZOTËRI I NDERUAR PENGOI GJAKDERDHJEN MES MUSLIMANËVE EDHE PSE ISHTE NË POZITË TË FORTË DHE KISHTE NËN UDHËHEQJE DHJETËRA MIJËRA KALORËS DHE SHPATA TË GATSHME, POR AI E REFUZOI LUFTËN SEPSE SHPRESOI ATË QË JEP ALLAHU. PRA, PASI QE KALIF PESË MUAJ, HOQI DORË VULLNETARISHT PËR T'IA LËNË VENDIN MUAVIUT, RADIJALLAHU ANHU, KËSHTU QË KY VIT, VITI 40H, U QUAJT VITI I XHEMATIT SEPSE NJERËZIT U BASHKUAN NËN NJË UDHËHEQËS PASI QENË TË PËRÇARË. I KISHIN THËNË NJËHERË HASANIT, RADIJALLAHU ANHU: "NJERËZIT PO PRETENDOJNË SE TI E DO KALIFATIN", KURSE AI THA: "KISHA NË UDHËHEQJE TË GJITHË ARABËT, QË DO TË MBANIN PAQE ME ATË QË MBAJA UNË DHE DO TA LUFTONIN ATË QË DO LUFTOJA UNË, POR I BRAKTISA DUKE KËRKUAR KËNAQËSINË E ALLAHUT."




## BUR


SIJERU ALAMI NUBELA, 5/314; NESEBU KURAJSH NGA IBËN BEKKAR, 5/75. -- EL-IRSHAD NGA EL-MUFID FQ.248; TARIHU TABERI, 4/359; NESEBU KURAJSH, 2/40. -- TARIHU TABERI, 5/270; EL-KAMIL FI TARIH NGA IBNUL ETHIR, NGJARJET E VITIT 30H; TARIH IBËN HALDUN, 2/135.

EL-BIDAJE UE NIHAJE NGA IBËN KETHIRI, 8/151; TARIHU TABERI, 6/148; BUGJETU TALEB FI TARIHI HALEB NGA IBNUL ADIM, 3/8. -- TARIH IBËN HALDUN, 2/128. -- MUNTEHAL AMAL NGA EL-KAMI, FQ. 568; NEFSUL MEHMUM NGA ABBAS EL-KAMI FQ. 365.

TARIHU TABERI, 4/346; MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FEREXH EL-ESFEHANI, FQ. 80, DHE EMANI SADUK, FQ. 226. - BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 44/333; TARIHU DIMESHK NGA IBËN ASAKIR, 14/216; AJANU SHIA, FQ.26; EL-MELHAME EL-HUSEJNIJE NGA MURTEDA EL-MUTAHHIRI,

# IBËN ALI

## HE I PESTI NGA KALIFËT E MIRË (3-49H)

## XHIHADI I TIJ




## ...RIMET

1/129. -- MINHAXHU SUNNE NGA IBËN TEJMIJE, 4/557; TARIH TABERI, 3/339; BUGJETU TALEB FI TARIHI HALEB NGA IBNUL ADIM, 3/38; EL-IRSHAD NGA EL-MUFID, 2/122, DHE BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 45/146. - EL-BIDAJE UE NIHAJE, 8/174; TARIHU DIMESHK, 14/208; EL-FUSULUL MUHIMME NGA IBËN SABBAG, 2/802; MEKATILI TALIBIN NGA EL-ESFEHANI, FQ. 73, DHE BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 44/185. -- TARIHU TABERI, 4/343; AJANU SHIA NGA MUHSIN EL-EMIN, 2/302; SHERHUL AHBAR NGA EN-NUMANI, 3/177, DHE MEKATILU TALIBIN NGA EL-ESFEHANI, FQ.75. -- SUNNEN NGA IMAM EL-HAL'LAL, 3/522. -- MEXHMUUL FETAV NGA IBËN TEJMIJE, 4/487, DHE MINHAXHU SUNNE NEBEVIJE NGA IBËN IBËN TEJMIJE, 4/550. -- ET-TEDHKIRAH NGA KURTUBIU, 2/215.

## NGA VLERAT E TIJ

- EBU HUREJRA, RADIJALLAHU ANHU, PËRCJELL SE PEJGAMBERI, ALEJHI SALATU UE SELAM, PËR HASANIN KISHTE THËNË: "**O ALLAH, DUAJE DHE DUAJE ATË QË E DO ATË.**" SHËNON BUHARIU (2016) DHE MUSLIMI (2421).
- ABDULLAH IBËN OMER IBËN HATTABI, RADIJALLAHU ANHUMA, PËRCJELL SE PEJGAMBERI, ALEJHI SALATU UE SELAM, PËR HASANIN DHE HUSEJNIN, RADIJALLAHU ANHUMA, KA THËNË: "**ATA JANË DY LULET E MIA NGA KJO DYNJA.**" BUHARIU (3543)
- EBU SEID EL-HUDRIJU, RADIJALLAHU ANHU, PËRCJELL SE PEJGAMBERI, ALEJHI SALATU UE SELAM, KA THËNË: "**HASANI DHE HUSEJNI JANË ZOTËRINJTË E RINISË SË XHENETIT.**" MUSNEDI I AHMEDIT (11012); SUNEN KUBRA NGA NESAI (8525), DHE TIRMIDHIU (3768)

## I PESTI NGA KALIFËT E MIRË

SEFINEH, SHËRBËTOR I PEJGAMBERIT, PËRCJELL SE PEJGAMBERI, ALEJHI SALATU UE SELAM, KA THËNË: "KALIFATI NË UMETIN TIM DO TË JETË TRIDHJETË VITE E PASTAJ MBRETËRI."
PAS PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, NË TRIDHJETË VITET VIJUESE NUK KISHTE PËRVEÇSE KATËR KALIFËT DHE PESË MUAJT E UDHËHEQJES SË HASANIT, RADIJALLAHU ANHU . KUR PËRFUNDOI AI INTERVAL KOHOR, FAKTIKISHT HASANI, RADIJALLAHU ANHU, HOQI DORË NGA KALIFATI PËR T'IA DORËZUAR MUAVIJUT, RADIJALLAHU ANHU. ME KËTË U VËRTETUA EDHE NJË PROFECI E PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, PRA, AJO QË U PËRMEND NË HADITHIN E SIPËRPËRMENDUR.

## DJEMTË E TIJ

## GRATË E TIJ

- TALHA ← NGA AJO LINDI — UMMU IS'HAK BINT TALHA IBËN UBEJDULLAH
- EBU BEKRI, I CILI RA SHEHID NË KERBELA; UMMUL HASEN, QË U MARTUA ME ← NGA AJO LINDI — MELIKA BINT AHNEF IBËN KAJS
- ZEJDI ← NGA AJO LINDI — UMMU BESHIR BINT EBU MESUD EL-ENSARI EL-BEDRI
- HASEN EL-MUTHENNA ← NGA AJO LINDI — HAULE BINT MENDHUR EL-FEZARI

HASEN EL-MUTHENNA:
- IBRAHIM EL-GAMR
  - BENU TABATABA
    - MUHAMED IBËN TABATABA "BABAI I IMAMËVE" NË SA'DA TË JEMENIT
- ABDULLAH EL-KAMIL (EL-MAHD) NGA PASARDHËSIT E KËTIJ
  - SULEJMAN
    - SHTETI I BENI MUHAMED EL-UHAJDAR NË JEMAME
  - IDRIS
    - SHTETI I EL-EDARISE NË MAROK
      - SHTETI I BENI HAMUD NË ANDALUZI (SHTETI I FUNDIT I BENI UMEJJE)

HAFSA BINT ABDURRAHMAN IBËN EBI BEKËR
POR ËSHTË THËNË SE KJO QE GRUA E HUSEJNIT, RADIJALLAHU ANHU, E CILA NJËKOHËSISHT ËSHTË EDHE TEZJA E UMMU FERUASË, NËNËS SË XHAFER ES-SADIKUT

***HASANI KA PASUR 16 FËMIJË, PREJ TË CILËVE 11 MESHKUJ***

# HUSEJN

(LINDI NË VITIN

I DËRGUARI KA THËNË:

**"HASANI DHE HUSEJNI JANË ZO**

## VRASËSIT E TIJ

**PARA BETEJËS**
BANORËT E KUFES, TË CILËT SË BASHKU ME FËMIJËT E TYRE DOLËN PËR TA LUFTUAR .

**GJATË BETEJËS**
UBEJDULLAH IBËN ZIJADI (I CILI DHA URDHRIN E VRASJES), OMER IBËN SADI (KOMANDANTI I USHTRISË) DHE USHTRIA QË LUFTOI KUNDËR TIJ, POR NË VEÇANTI ATA TË DY QË KRYEN VRASJEN:
- SINAN IBËN ENES EN-NAHAI
- SHEMËR IBËN DHILXHEUSHIN

## TRADHTARËT E TIJ

1. ATA BANORË TË KUFES QË E MASHTRUAN ME LETRA DHE SHKRIME .
2. JEZID IBËN MUAVIJE, I CILI NUK I DOLI KRAH KUNDËR VRASËSVE, MADJE AS NUK I NDËSHKOI, POR U MJAFTUA DUKE E FYER UBEJDULLAH IBËN ZIJADIN DHE DUKE E DETYRUAR ME KOMPENSIM MATERIAL NDAJ FAMILJES SË HUSEJNIT ﷺ

## NDIHMËTARËT E TIJ

**PARA BETEJËS:**
SAHABËT DHE ANËTARËT E SHTËPISË FISNIKE, TË CILËT E KËSHILLUAN TË MOS DILTE, SI IBËN ABASI, IBËN OMERI, IBËN ZUBEJRI, MUHAMED IBËN ALI (IBNUL HANEFIJE), ABDULLAH IBËN XHAFER IBËN EBI TALIBI, ABDULLAH IBËN MUTIË, ABDULLAH IBËN AJASH, JEZID IBNUL ESAMM DHE EBU UAKID EL-LEJTHI.

**GJATË BETEJËS:**
VËLLEZËRIT E TIJ EBU BEKRI, ABASI, OTHMANI, XHAFERI DHE ABDULLAHU SË BASHKU ME DJEMTË E TIJ DHE DJEMTË E VËLLEZËRVE TË TIJ DHE CA SAHABË SIKURSE HURR IBËN JEZID ET-TEMIMI.

**PAS BETEJËS:**
DIJETARËT, TË CILËT E DËNUAN RASTIN DHE SHFUQIZUAN DINJITETIN E ATYRE QË MORËN PJESË NË VRASJEN E HUSEJNIT.

**NGA ATA DIJETARË ISHIN:**
- EBU BEKËR IBNUL HAL'LAL, I CILI THA: "ALLAHU E MALLKOFTË ATË QË VRAU HUSEJNIN BIRIN E ALIUT! ALLAHU E MALLKOFTË ATË QË VRAU OMERIN! ALLAHU E MALLKOFTË ATË QË VRAU OSMANIN DHE ALLAHU E MALLKOFTË ATË QË VRAU ALIUN!"
- TEKIJJUDDIN IBËN TEJMIJE, I CILI KA THËNË: "SA I PËRKET ATIJ QË VRAU HUSEJNIN OSE QË NDIHMOI NË ATË VRASJE OSE U PAJTUA ME ATË VRASJE, MBI ATA QOFTË MALLKIMI I ALLAHUT, MALLKIMI I MELAIKEVE DHE I GJITHË NJERËZVE!"
- KURTUBIU, I CILI PËR HUSEJNIN R.A. DHE PËR VRASËSIN E TIJ THA: "ALLAHU E MËSHIROFTË ATË DHE MOS E MËSHIROFTË VRASËSIN E TIJ" SI DHE: "ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TIJ E MOS U KËNAQTË ME VRASËSIN E TIJ!"





SIJERU ALAMI NUBELA, 5/314; NESEBU KURAJSH NGA IBËN BEKKAR, 5/75. -- EL-IRSHAD NGA EL-MUFID FQ.248; TARIHU TABERI, 4/359; NESEBU KURAJSH, 2/40. -- TARIHU TABERI, 5/270; EL-KAMIL FI TARIH NGA IBNUL ETHIR, NGJARJET E VITIT 30H; TARIH IBËN HALDUN, 2/135.
EL-BIDAJE UE NIHAJE NGA IBËN KETHIRI, 8/151; TARIHU TABERI, 6/148; BUGJETU TALEB FI TARIHI HALEB NGA IBNUL ADIM, 3/8. -- TARIH IBËN HALDUN, 2/128. -- MUNTEHAL AMAL NGA EL-KAMI, FQ. 568; NEFSUL MEHMUM NGA ABBAS EL-KAMI FQ. 365.
TARIHU TABERI, 4/346; MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FEREXH EL-ESFEHANI, FQ. 80, DHE EMANI SADUK, FQ. 226. - BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 44/333; TARIHU DIMESHK NGA IBËN ASAKIR, 14/216; AJANU SHIA, FQ.26; EL-MELHAME EL-HUSEJNIJE NGA MURTEDA EL-MUTAHHIRI, 1/129.

# IBËN ALI رضي الله عنهما

4H, RA SHEHID NË VITIN 61H)

## TËRINJTË E RINISË SË XHENETIT."




-- MINHAXHU SUNNE NGA IBËN TEJMIJE, 4/557; TARIH TABERI, 3/339; BUGJETU TALEB FI TARIHI HALEB NGA IBNUL ADIM, 3/38; EL-IRSHAD NGA EL-MUFID, 2/122, DHE BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 45/146. - EL-BIDAJE UE NIHAJE, 8/174; TARIHU DIMESHK, 14/208; EL-FUSULUL MUHIMME NGA IBËN SABBAG, 2/802; MEKATILI TALIBIN NGA EL-ESFEHANI, FQ. 73, DHE BIHARUL ENUAR NGA EL-MEXHLISI, 44/185. -- TARIHU TABERI, 4/343; AJANU SHIA NGA MUHSIN EL-EMIN, 2/302; SHERHUL AHBAR NGA EN-NUMANI, 3/177, DHE MEKATILU TALIBIN NGA EL-ESFEHANI, FQ.75. -- SUNNEN NGA IMAM EL-HAL'LAL, 3/522. -- MEXHMUUL FETAV NGA IBËN TEJMIJE, 4/487, DHE MINHAXHU SUNNE NEBEVIJE NGA IBËN IBËN TEJMIJE, 4/550. -- ET-TEDHKIRAH NGA KURTUBIU, 2/215.

## FËMIJËT E TIJ

**ALIU – ZEJNUL ABIDIN, MUHAMEDI, XHAFERI, ALI EL-EKBER, SUKEJNEJA, FATIMJA, (KURSE OMERI, ABDULLAH ER-RADIË DHE ALI EL-ESGAR JANË DISKUTABILË)**

## VËLLEZËRIT DHE MOTRAT E TIJ

**ALI IBËN EBI TALIBI ﷺ KA PASUR SHUMË FËMIJË.**

*** NGA MË TË NJOHURIT JANË:**

- HASANI DHE HUSEJNI ﷺ
- MUHAMED IBNUL HANEFIJE
- EBU BEKËR, ABBAS, OTHMAN, XHAFER, ABDULLAH – KËTA RANË DËSHMORË SË BASHKU ME HUSEJNIN R.A.
- OMERI (KY ISHTE FËMIJA I ALIUT ﷺ QË JETOI MË SË SHUMTI).

*** KURSE MOTRAT E HUSEJNIT ISHIN SHUMË, MË TË NJOHURAT:**

ZEJNEB, UMMU KULTHUM, HADIXHE, MEJMUNE, REMLA DHE XHUMANE

## DHËNDRIT E TIJ

### FATIMJA

**BASHKËSHORTËT E SAJ:**

1.HASAN IBËN HASAN IBËN ALI IBËN EBI TALIB
2. ABDULLAH IBËN AMËR IBËN OSMAN IBËN AFFAN

### SUKEJNE

**BASHKËSHORTËT E SAJ:**

1. ABDULLAH IBËN HASAN IBËN ALI IBËN EBI TALIB
2. MUS'AB IBËN ZUBEJR IBËN AVAM
3. ESBEG IBËN ABDULAZIZ IBËN MERVAN IBËN HAKEM
4. ZEJD IBËN AMËR IBËN OSMAN IBËN AFFAN
5. ABDULLAH IBËN OTHMAN IBËN ABDULLAH IBËN HAKIM IBËN HIZAM
6. IBRAHIM IBËN ABDURRAHMAN IBËN AUF

**BURIMET:**

TARIHU BAGDAD NGA HATIB EL-BAGDADI, 5/368; SIJERU ALAMI NUBELA, 11/265; ENSABUL ESHRAF NGA BELADHIRI (TEMA: FËMIJËT E HUSEJNIT); A'JANU SHIA NGA MUHSIN EL-EMIN, 3/492; TARIHUL EUSAT NGA IMAM BUHARIU, 1/345; TARIHU DIMESHK NGA IBËN ASAKIR, 9/170; EL-MUHBIR NGA IBËN HABIB, FQ. 438; MIR'ATUL XHINAN NGA EL-JAFII, 1/117; MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FERAXH EL-ESFEHANI, FQ. 120 – *MEGJITHËSE HISTORIANËT KANË DIVERGJENCË NË RADHITJEN E BASHKËSHORTËVE TË SUKEJNES DHE SE TRE PREJ TYRE PATËN VDEKUR SHUMË SHPEJT PAS MARTESËS.*

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË ALI IBËN EBI TALIBIT DHE FAMILJES SË ZUBEJR IBËN AVVAMIT

**13 KRUSHQI**
mes familjes së Aliut
dhe familjes së Zubejrit
përgjatë një shekulli

## KUSAJ IBËN KILABI

ABDULMUTALIB IBËN HASHIM IBËN ABDUMENAFI → ALI IBËN EBI TALIBI

HUVEJLID IBËN ESED IBËN ABDULUZZA → ZUBEJR IBËN AVVAMI

| Pasardhësit e Ali ibën Ebi Talibit | | Pasardhësit e Zubejr ibën Avvamit | Nr. |
|---|---|---|---|
| → FATIME | ○ | MUNDHIR ← UBEJDE | 1 |
| HASANI → HASANI → MELIKE | ○ | XHAFER ← MUSABI | 2 |
| HASANI → RUKAJJA | ○ | AMËR ← MUNDHIR | 3 |
| HASANI → HASANI → ABDULLAH → MUHAMED | ○ | FAHITA ← FULEJH ← MUHAMED ← MUNDHIR | 4 |
| HASANI → HUSEJN | ○ | EMINE ← HAMZA ← MUNDHIR | 5 |
| HASANI → NEFISEH (UMMUL HAASEN) | ○ | ← ABDULLAH | 6 |
| HUSEJN → SUKEJNE | ○ | ← MUSABI | 7 |
| HUSEJN → ALI → HUSEJN | ○ | HALIDE ← HAMZA ← MUSABI | 8 |
| HUSEJN → ALI → OMER → MUSA | ○ | UBEJDA ← ZUBEJR ← HISHAM ← URVEH | 9 |
| HUSEJN → ALI → OMER → XHAFER | ○ | FATIME ← OTHMAN ← URVEH | 10 |
| HASANI → ALI → HASANI → IBRAHIM | ○ | BERIKA ← UBEJDULLAH ← MUHAMED ← MUNDHIR | 11 |
| MUHAMED → ALI → AUN → MUHAMED | ○ | SAFIJE ← MUHAMED ← MUSABI | 12 |
| HUSEJN → ALI → HUSEJN → ABDULLAH | ○ | UMMU AMËR ← AMËR ← ZUBEJR ← AMËR | 13 |

**VINI RE: KY TRUNG PARAQET NJË PJESË TË KRUSHQIVE DHE PREJARDHJEVE DHE JO TË GJITHA!**

MARTESË ○ ATËSI →

Allahu ka thënë: "Muhamedi është i Dërguar i Allahut, ndërsa ata që besuan së bashku me të janë të ashpër ndaj mohuesve dhe të mëshirshëm mes vete".

Këtë trung krushqie e theksuan dhe e dëshmuan burimet e muslimanëve, të cilat dëshmojnë për raportet e ngrohta mes Shtëpisë Fisnike dhe sahabëve e po ashtu edhe pasardhësve të tyre përgjatë gjeneratave. Prandaj, le të kemi kujdes nga të paqenat në histori!


BURIMET MË TË RËNDËSISHME:

- EL MEARIF NGA IBËN KUTEJBE, 224;- NESEBU KURAJSH, 19, 26;
- SHEXHERATU TUBA NGA MUHAMED MEHDI EL-HAIRI, 120;- EL MUHBIR NGA IBËN HABIB, 57;
- XHEMHERATU ENSABIL ARAB NGA IBËN HAZM 22, 53, 55;
- MUSTEDRAKATU ILMI RIXHAL NGA EN-NEMAZI, BIOGRAFIA NR. 8226;
- SIRUS SILSILE ELALEVIJE NGA EBU NASR EL-BUHARI 8, 69, 78, 79;
- EL MEXHDI FI ENSABI TALIBIN NGA ALIB B. MUHAMMED ELALEVIJ, 195;
- MUXHEMU RIXHALIL HADITH NGA EL-HAV'I, 12/76.-ET TABEKATUL KUBRA NGA IBËN SAD, 5/327.

QARTËSIMI I GJASHTËMBËDHJETË

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË ALI IBËN EBI TALIBIT DHE FAMILJES SË ZUBEJR IBËN AVVAMIT, RADIJALLAHU ANHUMA

Në vazhdën e udhëtimit të dashurisë së palëkundshme mes Shtëpisë Fisnike dhe sahabëve në përgjithësi dhe familjes së Aliut dhe asaj të Zubejrit, radijAllahu anhuma, në veçanti e ka radhën edhe ky qartësim, ku vërejmë këto gjëra:

1. Këto krushqi janë lidhur pas betejës El-Xhemel të vitit 36h., për të na dhënë një dritë të madhe dhe të qartë se konflikti i El-Xhemelit nuk e prishi dashurinë mes tyre dhe se ajo urrejtje dhe armiqësi që shpifin dhe stolisin orientalistët nuk ka themel, por vetëm thashetheme të falsifikuara.
2. Numri i këtyre krushqive përgjatë një shekulli dhe ndër gjashtë gjenerata me radhë te djemtë dhe nipat arriti në trembëdhjetë.
3. (Hisja e shtëpisë së Hasanit, radijAllahu anhu, ishte pesë krushqi: me një bir, një nip, me dy vajza të Hasanit (Rukajja dhe Nefise) dhe një mbesë (Melika))
4. Hisja e shtëpisë së Husejnit, radijAllahu anhu, ishte gjithashtu gjashtë krushqi, nga ato ishin pesë burra, që të gjithë nipa të Ali ibën Husejnit dhe një ishte me bijën e Husejnit, Sukejnen.
5. Hisja e shtëpisë së Musabit, djalit të Zubejrit, ishte katër krushqi me familjen e Aliut, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre!

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË ALI IBËN EBI TALIBIT DHE TALHA IBËN UBEJDULLAHUT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ ATYRE TË DYVE!




PËRPUTHJA MES EMRAVE NË NUMRA ALUDON PËR MARTESËN MES ATYRE PERSONAVE TË NDERUAR NGA SHTËPIA FISNIKE DHE FAMILJA E TALHAIT, RADIJALLAHU ANHU

## BURIMET MË TË RËNDËSISHME:

- EL MEARIF NGA IBËN KUTEJBE, 232;
- ENSABUL ESHRAF NGA EL-BELADHIRI, 1/474;
- XHEMHERATU ENSABIL ARAB, 52;
- MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FERAXH EL-ESFAHANI, 122;
- NESEBU KURAJSH NGA EZ-ZUBEJRI, 25;
- TAXHUL MEVALID NGA ET-TUBRUSI, 35;
- EL IRSHAD NGA EL-MUFID, 2/130.
- EL MUHBIR NGA IBËN HABIB, 438, 448, 450.

VINI RE: KY TRUNG PARAQET NJË PJESË TË KRUSHQIVE DHE PREJARDHJEVE DHE JO TË GJITHA!

ALLAHU KA THËNË: "MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUAR I ALLAHUT NDËRSA ATA QË BESUAN SË BASHKU ME TË JANË TË ASHPËR NDAJ MOHUESVE DHE TË MËSHIRSHËM MES VETE".
KËTË TRUNG KRUSHQIE E THEKSUAN DHE E DËSHMUAN BURIMET E MUSLIMANËVE PËR RAPORTET E AFËRTA MES SHTËPISË FISNIKE DHE SAHABËVE DHE SE KRUSHQIA MES TYRE PAS NGJARJEVE TË FITNES VAZHDOI SIKURSE MË PARË, ÇKA DËSHMON PËR RAPORTET E TYRE TË NGROHTA PËRGJATË HISTORISË. PRANDAJ, LE TË KEMI KUJDES NGA TË PAQENAT NË HISTORI!

QARTËSIMI I SHTATËMBËDHJETË

# KRUSHQITË MES FAMILJES SË ALI IBËN EBI TALIBIT DHE TALHA IBËN UBEJDULLAHUT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ ATYRE TË DYVE!

Ky qartësim mëton argumentin shtesë, se duhet të kemi kujdes nga gënjeshtrat që janë përhapur rreth konfliktit El-Xhemel. Nëse zemrat i kishin përplot urrejtje e armiqësi ndaj njëri-tjetrit, ç'ishte ajo që i shtyu besimtarët e Shtëpisë Fisnike të lidhin krushqi me familjen e Zubejrit dhe të Talhait?

Sa i përket Talhait, ai qe biri i Ubejdullah ibën Othman ibën Amër ibën Kab ibën Sad ibën Tejm ibën Murra ibën Kab ibën Luej ibën Galib nga fisi Kurejsh, familja et-Tejmi. Ai është një nga të përgëzuarit me xhenet. Ishte një nga tetë njerëzit e parë që pranuan Islamin. Një nga të pestët që pranuan Islamin nga Ebu Bekri. Një nga gjashtë e anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e kalifit të tretë. Arritjet dhe vlera e tij nuk është diçka e padukshme, por nga ky qartësim do të kisha ndarë këto:

1. Hasani, radijAllahu anhu, u martua me Umu Is'hak bijën e Talhait, radijAllahu anhu, e cila lindi një djalë, të cilin vetë Hasani do ta emërtonte Talha.
2. Me të njëjtën grua pas vdekjes së Hasanit u martua edhe shehidi Husejn, radijAllahu anhu, që e kish edhe amanet, e cila pastaj lindi një zonjë të respektuar me emrin Fatimja e vogël.
3. Pyetje: A nuk morën pjesë Hasani dhe Husejni në betejën e El-Xhemelit? Pse atëherë martohen me pasardhës të Talhait, gjithmonë, sikur të ishte ajo betejë ashtu siç e përshkruajnë orientalistët dhe bishtat e tyre?
4. Abdullah el-Mahd ibën Elhasen ibën Hasan ibën Ali ibën Ebi Talibi ashtu edhe Aun ibën Muhamed ibën Ali ibën Talibi u martuan me mbesën e Talhait, pra me Hafsa bint Imran ibën Ibrahim ibën Muhamed ibën Talha. Muhamedi së bashku me Talhain ranë dëshmorë në konfliktin e El-Xhemel.
5. Mbesa e Husejnit, Abde bint Ali ibën Husejn, radijAllahu anha, u martua me nipin e Talhait, Nuhun birin e Ibrahim ibën Muhamed ibën Talha. Ajo është motra e Muhamed el-Bakir, halla e Xhafer es-Sadikut dhe bija e Ali Zejnul Abidinit.
6. A nuk po vëren o lexues i shtrenjtë dhe fisnik se ngjitja e plasaritjeve në umet ishte gjithmonë synim kryesor me të cilin u preokupuan Shtëpia Fisnike dhe shokët e Pejgamberit?! Sa shëmbëlltyrë e mirë që ishin!

# DHËNDRIT E HUSEJN IBËN ALI IBËN EBI TALIBIT, RADIJALLAHU ANHU, NGA PASARDHËSIT E SAHABËVE, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE!




**ARSYET PËR MARTESAT E SHUMTA TË SUKEJNES ISHIN TË NDRYSHME, SIKURSE RËNIA DËSHMOR APO VRASJA E NDONJËRIT, DISA NUK JETUAN GJATË PAS MARTESËS DHE NJË RAST DIVORCI.**

**BURIMET MË TË RËNDËSISHME:**

- TARIHU DIMESHK NGA IBËN ASAKIR; - AJANU SHIA NGA MUHSIN EMIN EL-AMILI; ; - MUNTEHAL AMAL NGA ABBAS EL-KAMI. ; - ET TABEKATUL KUBRA NGA IBËN SADI; ; - ENSABUL ESHRAF NGA EL-BELADHIRI; ; - EL MUHBIR NGA IBËN HABIB. ; - XHEMHERATU ENSABIL ARAB NGA IBËN HAZM; ; - TEDHKIRATUL FUKAHA NGA EL-HILJI; ; - EL ESILI NGA IBËN TAKTAKI. ; - NESEBU KURAJSH NGA ZUBEJR IBËN BEKKAR; ; - MEKATILU TALIBIN NGA EBUL FERAXH EL-ESFAHANI; KESHFUL GUMME NGA EL-ERBILI.

QARTËSIMI I TETËMBËDHJETË

# DHËNDRIT E HUSEJN IBËN ALI IBËN EBI TALIBIT, RADIJALLAHU ANHU, NGA PASARDHËSIT E SAHABËVE, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE!

Ejani së bashku me mua te djemtë e Husejnit, radijAllahu anhu, më konkretisht te biri i tij Aliu me motrat e tij Fatimen dhe Sukejnen. Duke hulumtuar gjetëm se ata kishin marrë pjesë në Kerbela së bashku me babanë e tyre Husejnin dhe me vëllezërit e tjerë si dhe me kushërinjtë e tyre. Ajo që tani na intereson është:

1. Hasan Elmuthenna ibën Hasan ibën Ali ibën Ebi Talib, bashkëshorti i Fatimes së vogël doli i plagosur nga ajo betejë. Fatimja prej tij lindi Elhasenin, Abdullah el-Mahdin dhe Ibrahim el-Gamrin, që të gjithë njihen për zotërinj të mirë, po ashtu lindi Zejneben, e cila u martua me kalifin emevit Uelid ibën Abdulmelik, si dhe Ummu Kulthumen, e cila u martua me djalin e dajës së saj Muhamed el-Bakirin.
2. Kur Hasan Elmuthenna ndërroi jetë (97h), Fatimja u martua me Abdullah ibën Amër ibën Osman ibën Affanin, që njihej me nofkën el-Mutarrif dhe prej tij lindi Muhammed ed-Dibaxhin dhe një vajzë tjetër.
3. Kurse Sukejneja pati burrë Abdullahun birin e Elhasen ibën Ali ibën Ebi Talibit dhe ky është ai të cilit nëpër disa libra i thuhet Elkasim, kurse nofka e tij është Ebu Bekër. Ky ra shehid në betejën Taff së bashku me familjen e tij.
4. Pas tij, Sukejneja u martua me Musab ibën Zubejr ibën Avva-

min dhe nga ai lindi një vajzë të cilën e emërtoi Fatime.

5. Pasi u vra Musabi në vitin 71h., ajo u martua me Abdullah ibën Othman ibën Abdullah ibën Hakim ibën Hizamin, nga i cili lindi Othmanin (që njihet si Karin), Hakimin dhe Rabihan.
6. Pasi ai ndërroi jetë, u martua me Zejd ibën Amër ibën Osman ibën Affanin.
7. Pasi ai ndërroi jetë, u martua me Ibrahim ibën Abdurrahman ibën Auf, por ai e divorcoi pas tre muajsh.
8. Pastaj u martua me Elesbeg ibën Abdulaziz ibën Mervan ibën Hakemin, i cili qe vëllai i Omer ibën Abdulazizit, por edhe ky ndërroi jetë herët.

Këtu vërejmë:

- Në përgjithësi ai që ishte velijj – përgjegjës direkt për martesat e Sukejnes ishte vëllai i saj Ali ibën Husejni, radijAllahu anhu.
- Dy nga bashkëshortët e Sukejnes u vranë herët, një nga ata vdiq, tjetri e divorcoi pas ca muajsh – arsye që shpjegojnë martesat e shumta.
- Medito rreth asaj se bashkëshortët e këtyre dy bijave gjithmonë ishin djemtë ose nipat e sahabëve, sidomos të Osmanit, Zubejrit dhe Abdurrahman ibën Aufit, radijAllahu anhum. Ky fakt heq çdo dyshim dhe pastron çdo mendim, duke treguar se mes tyre ka pasur afërsi dhe dashuri që u trashëgua edhe te pasardhësit.

# MUHAMMED EL-BAKIR

## MUHAMMED IBËN ALI IBËN HUSEJN IBËN ALI IBËN EBI TALIB

(56 – 114H)

### MËSUESIT E TIJ NGA SAHABËT

- (NËNA E BESIMTARËVE) UMMU SELEME (HINDI NGA MAHZUMËT)
- EBU SEID EL-HUDRIJ EL-ENSARI
- ENES IBËN MALIK EL-ENSARI
- XHABIR IBËN ABDULLAH EL-ENSARI
- ABDULLAH IBËN ABAS EL-HASHIMI
- ABDULLAH IBËN OMER IBËN HATTAB

**PREJ FJALËVE TË MUHAMMED EL-BAKIR:**

- U PYET PËR STOLISJEN E SHPATAVE DHE U PËRGJIGJ: "NUK PRISH PUNË, NJË GJË TË ATILLË E KA BËRË EDHE EBU BEKËR SIDDIKU (I SINQERTI)." DIKUSH THA: "TI PO E QUAN ATË SIDDIK?" ATËHERË EL-BAKIRI U ÇUA PESHË, U DREJTUA NGA KIBLA DHE THA: "PO, SIDDIKU! PO, SIDDIKU! PO, SIDDIKU! DHE KUSH NUK THOTË PËR TË SIDDIKU, ATËHERË KURRË ALLAHU MOS IA PRANOFTË ASNJË FJALË, AS NË DYNJA DHE AS NË AHIRET!"

**PËR MUHAMMED EL-BAKIR U THA:**

- IMAM, I BESUESHËM, ZOTËRIA I HASHIMITËVE NË KOHËN E TIJ. MORI NOFKËN EL-BAKIR NGA FJALIA BEKAREL ILME, QË DOMETHËNË E PËRSHKOI DHE E ÇAU THELLËSINË E DITURISË DHE NJOHU THELBIN E GJËRAVE DHE IMTËSITË.

AI KA MBI 240 TRANSMETIME TË SHËNUARA NË NËNTË LIBRA

### NËNA E TIJ

**Ummu Abdullah**
*bint Hasan ibën Ali ibën Ebi Talib*

### NGA BASHKËSHORTET E TIJ

**Ummu Ferua**
*bint Elkasim ibën Muhammed ibën Ebu Bekër es-Siddik*


**BURIMET:**

- EL ESILI NGA IBËN TAKTAKI, 149 -UMDETU TALIB NGA IBËN ANBE, 345 -TEHDHIBUL KEMAL NGA EL-MIZZI, 26/137.
- SIJERU ALAMI NUBELA NGA DHEHEBIU, 4/402 -TEDHKIRATUL HUFADH NGA DHEHEBIU, 1/124 -KESHFUL GUMME NGA EL-ERBILI, 2/360.

QARTËSIMI I NËNTËMBËDHJETË

## MUHAMMED EL-BAKIR, RADIJALLAHU ANHU

Ai është imami, zotëria, Ebu Xhafer Muhammed ibën Ali ibën Husejn ibën Ali ibën Ebi Talib, nga qyteti i Medinës, baba kishte Zejnul Abidinin, lindi në vitin 56h.

Mori nofkën El-Bakir nga fjalia BEKAREL ILME, që domethënë e përshkoi dhe e çau thellësinë e diturisë dhe njohu thelbin e gjërave dhe imtësitë.

Nga mësuesit më të mëdhenj dhe më të njohur që pati ishin disa sahabë fisnikë, sikurse Xhabir ibën Abdullah el-Ensari, Enes ibën Maliku, Ebu Seid el-Hudrij, Abdullah ibën Omeri, Abdullah ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, çka na jep një provë të ndritshme për mbajtjen e raporteve të dijes dhe kulturës mes Shtëpisë Fisnike dhe sahabëve.

Madje, El-Bakiri përcolli 244 transmetime në librat bazë të hadithit profetik, pa numëruar fare këtu transmetimet që u përcollën nga ai në librat e tefsirit dhe në të tjerë.

Kemi përmendur se Muhammed el-Bakir qe dhëndër në shtëpinë e Ebu Bekër Siddikut me bijën e tyre Ummu Ferua bint Elkasim ibën Muhammed ibën Ebu Bekër es-Siddik. Ajo lindi prej tij Xhafer es-Sadikun. Kështu shkoi rrugës së gjyshit të tij, Pejgamberit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin me të, kur u martua me të sinqertën Aishe, Allahu qoftë i kënaqur prej saj; me xhaxhanë e babait të tij Hasanit, radijAllahu anhu, kur u martua me Hafsën bijën e Abdurrahman ibën Ebu Bekër es-Siddikut; madje edhe me djalin e vëllait të tij Is'hak ibën Abdullah ibën Ali ibën Husejn, kur mori nuse nga shtëpia e Ebu Bekrit. Çfarë konkurrence afërsie, vëllazërie, dashurie dhe besnikërie!

Këtë qartësim po e përmbyll me atë që shënoi El-Erbili nga El-Bakiri kur ky i fundit u pyet për stolisjen e shpatave, me ç'rast u përgjigj: "Nuk prish punë, një gjë të atillë e ka bërë edhe Ebu Bekër Siddiku (i sinqerti)." Dikush tha: "Ti po e quan atë Siddik?" Atëherë El-Bakiri u çua peshë, u drejtua nga kibla dhe tha: "Po, Siddiku! Po, Siddiku! Po, Siddiku! Dhe kush nuk thotë për të Siddiku, atëherë kurrë Allahu mos ia pranoftë asnjë fjalë, as në dynja dhe as në ahiret!" (*Keshful Gumme,* 2/360)

# HAFSA E BIJA E MUHAMED (ED-DIBAXH)

## MBESA E KATËR KALIFËVE, TALHAIT DHE ZUBEJRIT رضي الله عنهم!




Ky diagram qartësues shfaq gërshetimin shoqëror, shkrirjen e prejardhjeve dhe krushqitë mes Shtëpisë Fisnike dhe sahabëve, ku po shohim se Hafsa e bija e Muhamed Dibaxhit del mbesë e Ebu Bekër Siddikut, Omer ibën Hattabit, Osmanin ibën Affanit, Ali ibën Ebi Talibit, Talha ibën Ubejdullahut dhe Zubejr ibën Avvamit, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithëve! Kjo thekson dhe na jep dije të qartë për thellësinë e raporteve shoqërore dhe afërsisë mes Shtëpisë Fisnike dhe sahabëve, radijAllahu anhum.

ATËSI — MARTESË — STËRGJYSHËRIT E HAFSËS NGA TË PËRGËZUARIT ME XHENET

**BURIMET:**


- El Muhbir nga Ibën Habib, 1/404;
- El Mud'hish nga Ibnul Xheuzi, 69;
- El Xheuherah fi Nesebi Nebiji uel Ashera nga El-Berri, 1/273;
- El Mearif nga Ibën Kutejbe, 200; Sherh Nehxhil Belagah nga Ibën Ebi Hadid, 15/266.

QARTËSIMI I NJËZETË

## HAFSA E BIJA E MUHAMED (ED-DIBAXH) – MBESA E KATËR KALIFËVE, TALHAIT DHE ZUBEJRIT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE!

Megjithëse kaluan afër 150 vite sërish mbeti e theksuar lidhja e ngushtë mes pasardhësve të Shtëpisë Fisnike dhe sahabëve. Argument për këtë është qartësimi që po bëjmë.

Hafsa ishte e bija e Muhamed ed-Dibaxhit i biri Abdullah el-Mutarrifit i biri i Amrit i biri i kalifit të mirë dhe udhëheqësit të drejtë Osman ibën Affanit, radijAllahu anhu.

Pra, një grua që rridhte nga Pejgamberi, alejhi salatu ue selam, nga Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu, Talha dhe Zubejri radijAllahu anhum.

Ajo kishte nënë Hadixhen, bijën Othmanit, birit të Urve ibën Zubejr.

Nëna e Urves ishte Esmaja, bija e Ebu Bekrit, radijAllahu anhu.

Në anën tjetër nëna e Muhamed Dibaxhit ishte Fatimja, bija e Husejnit, radijAllahu anhu.

Nëna e Fatimes ishte Ummu Is'hak, bija e Talha ibën Ubejdullah, radijAllahu anhu.

Nëna e Abdullah el-Mutarrifit ishte Hafsa, bija e Abdullah ibën Omer ibën Hattabit, radijAllahu anhu. Thuhet në version tjetër se quhej Zejneb, bija e Abdullah ibën Omerit.

A e vëren o lexues i shtrenjtë dhe i nderuar se sa larg kish arritur ai gërshetim interesant shoqëror?

A nuk e vëren qartë se pasardhësit e Shtëpisë Fisnike dhe të sahabëve ishin më të lartë se çdo konflikt i supozuar?

# NËNAT E BESIMTARËVE

## GRATË E ZOTËRISË SË PROFETËVE ﷺ




KËTO PREJARDHJE GJENDEN NË LIBRAT E HISTORISË DHE BIOGRAFIVE, PËRVEÇ AJO XHUVEJRIJES, BIJËS SË HARITHIT, RADIJALLAHU ANHA, RRETH SË CILËS KA DIVERGJENCË NËSE ISHTE NGA FISI KAHTAN APO NGA KAM'A IBËN ILJAS IBËN MUDAR NGA ADNANËT. SHUMICA E DIJETARËVE TË KËSAJ FUSHE PËRKRAHIN MENDIMIN E PARË.

QARTËSIMI I NJËZETENJËTË

# NËNAT E BESIMTARËVE – GRATË E ZOTËRISË SË PROFETËVE, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFTË ME TË!

Këtu mund të shohësh trungun e prejardhjes profetike dhe pikat se ku takohen nënat e besimtarëve, gjegjësisht gratë me të në prejardhje. Këtu sheh njëmbëdhjetë nënat e besimtarëve të radhitura sipas afërsisë gjenealogjike me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam.

Nga biografia e tyre do të veçonim:

1. Dalja nga trungu i prejardhjes profetike të dy nënave tona: Xhuvejrije bint Harith, e cila sipas mendimit më të vërtetë është familja Mustalak me prejardhje nga Kahtanët; dhe Safije bint Hujej, e cila është me prejardhje nga pasardhësit e Pejgamberit Is'hak, birit të Pejgamberit Ibrahim, alejhima selam.
2. Që të gjitha kanë ndërruar jetë pas Muhamedit, alejhi salatu ue selam, përveç zonjës së grave të xhenetit, Hadixhes, radijAllahu anha dhe Zejnebes bijës së Huzejmeut, radijAllahu anha.
3. Që të gjitha janë varrosur në varrezat Bekië përveç Hadixhes, e cila u varros në lagjen Haxhun të Mekës dhe Mejmunes, radijAllahu anha, e cila u varros në Seraf.
4. Zejnebeja, bija e Xhahshit, radijAllahu anha, qe e para që iu bashkëngjit Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, kur vdiq në

vitin 20h. Ajo po ashtu nga prejardhja takohej me Pejgamberin edhe për nga nëna, meqë takoheshin te Umejma bija e Abdulmutalibit, pra halla e Pejgamberit, alejhi salatu ue selam.

5. Aishja ka përcjellë 2210 hadithe, Ummu Selemeja 378, Mejmuneja 78, Hafsa 60, Zejnebeja bija e Xhahshit 11, Safija 10, Xhuvejrija 7 dhe Seudeja 5.
6. Nga të gjitha ato vetëm Aishja, radijAllahu anha, qe beqare kur u martua.
7. E fundit që ndërroi jetë nga ato ishte Ummu Seleme, në vitin 61h, kurse e fundit me të cilën ishte martuar Pejgamberi, alejhi salatu ue selam, ishte Mejmuneja, radijAllahu anha, në vitin 7h.

Këto ishin prejardhjet e zonjave dhe nënave tona, pra nënat e besimtarëve. Shihet se prejardhja e tyre gërshetohej me prejardhjen e bashkëshortit të tyre, Muhamed Mustafasë, alejhi salatu ue selam.

# DHJETË TË PËRGËZUARIT ME XHENET




KJO GJENEALOGJI GJENDET NË TË GJITHË LIBRAT E HISTORISË DHE ATO TË BIOGRAFIVE.

QARTËSIMI I NJËZETEDYTË

## DHJETË TË PËRGËZUARIT ME XHENET

Ky qartësim ka të bëjë me prejardhjen profetike fisnike dhe pikat ku takohen prejardhjet e dhjetë të përgëzuarve me prejardhjen e tij. nga të cilat është ai hadith që e shënoi Tirmidhiu në Sunenin e tij (vëll. 5, fq. 647, nr. 3747) nga Abdurrahman ibën Aufi i cili ka thënë: Resulullahu, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin me të, ka thënë: "Ebu Bekri në xhenet, Omeri në xhenet, Osmani në xhenet, Aliu në xhenet, Talha në xhenet, Zubejri në xhenet, Abdurrahman ibën Aufi në xhenet, Sadi në xhenet, Seidi në xhenet dhe Ebu Ubejde ibën Xherrahi në xhenet"."

**Mundësisht le të mbajmë mend këto pika:**

1. Këta sikur qenë të afërt me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, në misionin e tij që pati, qenë të afërt gjithashtu edhe për nga prejardhja.
2. Që të dhjetët së bashku me Muhamedin, alejhi salatu ue selam, baba kishin Pejgamberin Ismail, birin e Pejgamberit Ibrahim, alejhima selam.
3. Ofendimi në prejardhjen e dikujt përfshin edhe ofendim ndaj prejardhjes së Pejgamberit, alejhi salatu ue selam.
4. Dy prej tyre qenë nga bijtë e Zuhriut, dajallarëve të Muhamedit, alejhi salatu ue selam, pra, Sadi dhe Abdurrahmani, radijAllahu anhuma.
5. Dy prej tyre qenë nga bijtë e Tejmit; Ebu Bekri dhe djali i xhaxhait të tij Talhai, radijAllahu anhuma.

6. Dy prej tyre qenë nga bijtë e Adijut, dy kushërinjtë Omeri dhe Seidi, radijAllahu anhuma.
7. Nga prindërit e të dhjetëve vetëm babai i Ebu Bekrit, radijAllahu anhu, pranoi Islamin.
8. Prej tyre, katër u bënë kalifë kurse gjashtë ishin konsultantët për zgjedhjen e kalifit të tretë.
9. I pari nga ata që vdiq ishte Ebu Bekri, kurse i fundit ishte Sad ibën Ebi Vekasi, radijAllahu anhuma.
10. Omeri, Osmani, Aliu, Talhai dhe Zubejri, që të gjithë vdiqën duke u vrarë si dëshmorë.
11. Që të gjithë morën pjesë në Bedër dhe që të gjithë morën pjesë në Besëlidhjen Riduan përveç Osmanit, por në fakt ajo besëlidhje u bë për t'i dalë krah atij.


ÇLIRIMET E SHTETIT ISLAM DERI NË FUND TË EPOKËS SË KALIFËVE TË UDHËZUAR
EVROPA
ROMA
KONSTANDINOPOL
SARDINIJA
ARMENIA
AZERBEXHAN
TUMEJSA
SHTETET PAS LUMIT
AMURIJE
HERAKLE
KARTAXHA
SUKAJLE
KAJREVAN
UTBE IBËN FERKAD ELVELID IBËN UKBE
SEID IBËN AS
XHURXHAN
TUBURSTAN
KUMS
30 H
KABIL
KRIT
QIPRO
SUBEJTALE
26 H
DETI MESDHE
MUAVIJE IBËN EBI SUFJAN ABDULLAH IBËN EBI SERAH
DAMASK
TOKAT E SHAMIT
SAD IBËN EBI VEKAS ELMUTHENNA IBËN HARITHE HUDHEJFE IBËN JEMAN NUMAN IBËN MUKRIN EBU MUSA EL-ESHARI HALID IBËN VELID EBU UBEJDE ETH-THEKAFIJ
SIXHISTAN
HURASAN
AZIA
ABDULLAH IBËN EBI SERAH UKBE IBËN NAFI EL-FEHRI
TRIPOLI
BURKA
KUDSI
KUFE
ABDULLAH IBËN AMIR IBËN KUREJZ ABDURRAHMAN IBËN SEMURA ABDULLAH IBËN HAZIM ES-SULEMIJ SEHËL IBËN ADIJ EL-HAZREXHI
MILITAN
ABDULLAH IBËN EBI SERAH UKBE IBËN NAFI EL-FEHRI
ALEKSANDRIA
EBU UBEJDE IBËN XHERRAH HALID IBËN VELID SHURAHBIL IBËN HASENE JEZID IBËN EBI SUFJAN AMËR IBËN AS
BASRA
PERSIA
AMËR IBËN AS
FUSTAT
ALI IBËN EBI TALIBI DËRGOI NJË USHTRI NËN KOMANDËN E ELHARITH IBËN MURRA EL-ABDIT PËR TË ÇLIRUAR TOKAT E SINDIT
EGJIPTI
GJIRI ARABIK (PERSIK)
MEDINE
TOKAT E SINDIT
AFRIKA
NEUBA
AJDHAB
DETI I KUQ
MEKE
INDIA
ABDULLAH IBËN EBI SERAH UKBE IBËN NAFI EL-FEHRI
GADISHULLI ARABIK
BASHKIMI I GADISHULLIT ARABIK NËN UDHËHEQJEN E EBU BEKËR SIDDIKUT PAS REBELIMIT TË RENEGATËVE
ÇLIRIMET QË NDODHËN NË KOHËN E KALIFIT EBU BEKËR
ÇLIRIMET QË NDODHËN NË KOHËN E KALIFIT OMER
ÇLIRIMET QË NDODHËN NË KOHËN E KALIFIT OSMAN
KJO BETEJË U ZHVILLUA NË KOHËN E KALIFIT ALI
KOMANDANTËT QË UDHËHOQËN BETEJAT
NË KËTË BETEJË MORËN PJESË: HASANI, HUSEJNI, ABDULLAH IBËN OMERI, ABDULLAH IBËN ABASI, ABDULLAH IBËN ZUBEJRI DHE ABDULLAH IBËN AMËR IBËN ASI
TOKAT E SUDANIT
NILI
JEMEN
SANA
DETI ARABIK
ZAJLEI
KËTO ÇLIRIME JANË TRANSMETUAR NË MËNYRË TË PADISKUTUESHME NË LIBRAT E HISTORISË, KURSE NGA BURIMET KRYESORE PO VEÇOJ:
- TARIHU TABERI NGA IMAM TABERIU;
- TARIHUL ISLAM NGA IMAM DHEHEBIU;
- EL BIDAJE UE NIHAJE NGA IBËN KETHIRI;
- EL KAMIL FI TARIH NGA IBNUL ETHIRI;
- EL MUNTEDHIM NGA IBNUL XHEUZI;
- MURUXHU DHEHEB NGA EL-MESUDI;
- TARIH EL-JAKUBI·

QARTËSIMI I NJËZETETRETË

# ÇLIRIMET E SHTETIT ISLAM DERI NË FUND TË EPOKËS SË KALIFËVE TË UDHËZUAR, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TYRE!

Kjo hartë na shfaq numrin e çlirimeve që bënë kalifët e udhëzuar dhe shpejtësinë e zgjerimit të shtetit islam brenda tridhjetë vitesh. Popujt, tokat e të cilëve çliroheshin, e pranonin Islamin, mësonin edhe arabishten dhe merrnin pjesë në çlirimet e mëtutjeshme. Kështu çlirimi që bënin Shtëpia Fisnike dhe sahabët ishte fillimisht çlirimi i zemrave, pastaj i tokave dhe qyteteve.

Mund të paramendosh mjetet e luftës dhe të transportit atëbotë dhe pastaj ta krahasosh me madhësinë e atyre çlirimeve për ta mësuar madhështinë e sinqeritetit dhe trimërisë që kishin Shtëpia Fisnike dhe sahabët e nderuar. Vërehet qartas se si Allahu i drejtoi dhe i ndihmoi me përkrahjen e Tij, duke vërtetuar asisoj fjalën, lartësuar qoftë: "Nëse ju ndihmoni Allahun, Ai gjithsesi do t'ju ndihmojë dhe do t'jua forcojë këmbët." (Muhamed: 7)Harta gjithashtu informon për numrin shumë të madh të komandantëve çlirues që ishin sahabë, të cilët udhëtuan nga Lindja në Perëndim për të kumtuar fenë dhe për të ndihmuar Ligjin e Zotit të botëve.

Ja një shembull nga Shtëpia Fisnike e Profetit për ta parë se si ata u shpërndanë në rrugën e çlirimeve:

Ibën Abdulberr el-Endelusi ka thënë: "Thuhet se nuk janë parë varre më të largëta nga njëri-tjetri sesa varret e djemve të Abas ibën Abdulmutalibit. Nëna e tyre Ummul Fadël i lindi që të gjithë në një shtëpi, por Fadli ra shehid në Exhnadin, Mabedi dhe Abdurrahmani ndërruan jetë në Afrikë, Abdullahu vdiq në Taif, Ubejdullahi në Jemen, Kathemi në Semarkand dhe Kethiri në Janbu, kur u sëmur nga angjina." (El-Istiab, 1/59)

Harta gjithashtu na kujton pjesëmarrjen e Hasanit, Husejnit, Abdullah ibën Omerit, Abdullah ibën Abasit, Abdullah ibën Zubejrit dhe Abdullah ibën Amër ibën Asit, radijAllahu anhum, në çlirimin e qyteteve Xhurxhan dhe Tumejsa në Lindje në vitin 30h dhe në çlirimin e Afrikës dhe qytetit Subejtale në Perëndim në vitin 26h.

# ATYRE QË U RA HISE NDERI I AFËRSISË FAMILJARE DHE TË QENËT SHOK I PEJGAMBERIT ﷺ




Këtu kemi disa emra të atyre që patën fatin të kenë dy ndere, të afërsisë familjare dhe të qenët sahabë. Këta qenë të nderuarit, të cilët patën fatin të jenë afër Pejgamberit për nga prejardhja, por edhe për nga të qenët shok dhe pasues të tij, sal-lAllahu alejhi ue selem.

# ATYRE QË U RA HISE NDERI I AFËRSISË FAMILJARE DHE TË QENËT SHOK I PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM

Lexues i nderuar, këtu ke mbi njëqind emra të atyre që patën fatin të kenë dy ndere, të afërsisë familjare dhe të qenët sahabë. Këta qenë të nderuarit, të cilët patën fatin të jenë afër Pejgamberit për nga prejardhja, por edhe për nga të qenët shok dhe pasues të tij, sal-lAllahu alejhi ue selem.

Sigurisht e ke parasysh lexues i nderuar se gjenealogjia profetike është nder dhe vlerë, me të cilën është për qëllim ata që takohen me Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, te gjyshi Hashimi, ata që e kishin të ndaluar pranimin e lëmoshës, të cilëve u bashkëngjiten edhe bashkëshortet e të Dërguarit, pra, nënat e besimtarëve, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!

Nga dëshmitë se ne ushqejmë dashuri ndaj atyre njerëzve të nderuar është edhe kjo që po shfaqim emrat e tyre dhe e lusim Allahun të jetë i kënaqur prej tyre dhe e pranojmë pozitën dhe vlerën që gëzojnë ata.

Njëkohësisht themi se të gjithë atyre u korrespondon emri sahab, përkufizimi i të cilit është: Ai që takoi Pejgamberin, alejhi salatu ue selam, duke qenë besimtar dhe vdiq duke qenë musliman.

Në këtë qartësim i kemi bërë të dalluar në trung bijat, bashkëshortet, xhaxhallarët dhe djemtë e xhaxhallarëve të Pejgamberit, alejhi salatu ue selam, siç i kemi bërë të dalluar meshkujt prej femrave dhe ata për të cilët ka divergjencë nga ata që janë vërtetuar pa dyshim.

Allahu na e mundësoftë t'i pasojmë ata më së bukuri dhe na bashkoftë me ta në Firdeusin e lartë! Amin

## FUSNOTE

1 Shenjimi me 1B, 1G deri në gjashtë tregon numrin e martesave mes këtyre dy familjeve dhe kush me kë u martua. Me B aludohet burri dhe me G gruaja.

2 Lexuesi i nderuar që mediton mund të vërejë se në të gjitha këto gjashtë krushqi të bekuara burrat ishin nga familja fisnike, kurse gratë nga familja e Ebu Bekrit. Me qartësinë më të madhe kjo tregon për raportin e afërt mes atyre në përgjithësi dhe sidomos kur merret parasysh se shumica e këtyre martesave ndodhën pas ngjarjeve të grindjes.

3 Burimet kryesore që regjistruan këtë krushqi janë: *El-Esili nga Ibën Taktaki, fq.58; *B*iharul Enua*r nga El-Mexhlisi, 78/382; *El-Bidaje ue Nihaje n*ga Ibë*n Kethiri; * T*arihul Isla*m nga Dhehebiu, te ngjarjet e vitit 45h; *T*arihu Dimeshk*u nga Ibën Asakir, biografia e Zejd ibën Omer ibën Hattabit; *Edh-Dheria nga Aga Bezrak Tahrani, 5/184, *A'janu Shia nga Muhsin Emin, 3/486; *R*ijadul Mesai*l nga Tabatabai, 12/664; **Sijeru Alami Nubel*a nga Dhehebiu, 3/502; *K*eshfu Litha*m nga Fadil el-Hindi, 9/525; *K*ifajetul Ahka*m nga Sebzavi, 2/879; * El-Uafi fil uefejat nga *Es*-Safedi, 15/23; *U*esailu Shi*a nga Hur el-Amili, 26/314; *M*uhtelefu Shi*a nga El-Hilji, 2/308.

## PËRMBAJTJA

HYRJE....................................................................................................5

KRUSHQITË MES PEJGAMBERIT, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFSHIN MBI TË, DHE KALIFËVE TË MENÇUR................9

BIJAT E NJERIUT MË TË MIRË, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFSHIN ME TË ..........................................................11

MARTESA E BEKUAR E ALI IBËN EBI TALIBIT DHE FATIME EZ-ZEHRAS, RADIJALLAHU ANHUMA ..................................................13

DISA EMRA QË I DONTE ALIU DHE DJEMTË E TIJ, RADIJALLAHU ANHUM ..........................................................................................15

KRUSHQITË MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM DHE FAMILJES SË EBU BEKRIT, RADIJALLAHU ANHUM ..19

“EBU BEKRI MË KA LINDUR DY HERË.” ..........................................23

IMAM XHAFER ES-SADIKU..............................................................25

KRUSHQITË MES FAMILJES SË PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM, DHE ..........................................................................27

“UNË JAM BIR I DY KALIFËVE.” ......................................................29

OSMANI, RADIJALLAHU ANHU, NË SHTËPINË PROFETIKE...........31

KRUSHQITË MES FAMILJES PROFETIKE DHE FAMILJES SË OSMAN IBËN AFFANIT,

ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE!............................33

KRUSHQITË MES SHTËPISË FISNIKE DHE KUSHËRINJVE............35

ZUBEJRI NË SHTËPINË PROFETIKE.................................................37

HASAN IBËN ALI ..........................................................................39

HUSEJN IBËN ALI ........................................................................41

KRUSHQITË MES FAMILJES SË ALI IBËN EBI TALIBIT DHE FAMILJES SË ZUBEJR IBËN AVVAMIT, RADIJALLAHU ANHUMA....................43

KRUSHQITË MES FAMILJES SË ALI IBËN EBI TALIBIT DHE TALHA IBËN UBEJDULLAHUT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ ATYRE TË DYVE!..........................................................................................45

DHËNDRIT E HUSEJN IBËN ALI IBËN EBI TALIBIT, RADIJALLAHU ANHU, NGA PASARDHËSIT E SAHABËVE, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE! .......................................................47

MUHAMMED EL-BAKIR, RADIJALLAHU ANHU ...............................51

HAFSA E BIJA E MUHAMED (ED-DIBAXH) – MBESA E KATËR KALIFËVE, TALHAIT DHE ZUBEJRIT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TË GJITHËVE! ........................................................................53

NËNAT E BESIMTARËVE – GRATË E ZOTËRISË SË PROFETËVE, LAVDËRIMI DHE PAQJA E ALLAHUT QOFTË ME TË!........................55

DHJETË TË PËRGËZUARIT ME XHENET..........................................59

ÇLIRIMET E SHTETIT ISLAM DERI NË FUND TË EPOKËS SËKALIFËVE TË UDHËZUAR, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TYRE! ...............................................................................................63

ATYRE QË U RA HISE NDERI I AFËRSISË FAMILJARE  DHE TË QENËT SHOK I PEJGAMBERIT, ALEJHI SALATU UE SELAM........................65

FUSNOTE ..........................................................................................66

مبرة الآل والأصحاب

# الآل والصحابة
# محبة وقرابة

## معلقات ذات دلالة عميقة على العلاقة الحميمة بين الآل والأصحاب




إعداد

**علي بن حمد التميمي**

نائب رئيس مركز البحوث والدراسات بالمبرة



www.almabarrah.net

almabarrah

009652560203

ترجمة مؤسسة نون